



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

---

**PROJEKTLIGJI PËR SHËRBIMET PRIVATE TË SIGURISË<sup>1</sup>**

**DRAFT LAW ON PRIVATE SECURITY SERVICES<sup>2</sup>**

**NACRT ZAKONA O USLUGAMA PRIVATNOG OBEZBEĐENJA<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Projektligji për Shërbimet Private të Sigurisë, është aprovuar në mbledhjen e 178-të, të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr. 10/178, datë 13.12.2023.

<sup>2</sup> Draft Law on Private Security Services, was approved on the 178 meeting of the Government of Kosovo, with the Decision No.10/178 dated 13.12.2023.

<sup>3</sup> Nacrt Zakona o Uslugama Privatnog Obezbeđenja, usvojen je na 178 sednicu Vlade Kosova, sa Odlukom Br.10/178, datum 13.12.2023.

<p><b>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</b></p> <p>Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p><b>LIGJ PËR SHËRBIMET PRIVATE TË SIGURISË</b></p> <p><b>KAPITULLI I</b> <b>DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 1</b> <b>Qëllimi</b></p> <p>Ky ligj ka për qëllim të rregullojë kushtet, procedurat, aktivitetet dhe veprimtarinë e personave juridikë dhe fizikë që ofrojnë shërbime dhe aktivitete në fushën private të sigurisë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 2</b> <b>Fushëveprimi</b></p> <p>1. Dispozitat e këtij ligji janë të obligueshme për organet relevante në fushën e shërbimeve private të sigurisë, si dhe për personat e tjerë fizikë dhe juridikë, veprimtaria e të cilëve ndërlihet me shërbimet private të sigurisë.</p>	<p><b>The Assembly of the Republic of Kosovo,</b></p> <p>In support of Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Approves:</p> <p><b>LAW ON PRIVATE SECURITY SERVICES</b></p> <p><b>CHAPTER I</b> <b>GENERAL PROVISIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 1</b> <b>Purpose</b></p> <p>This Law shall aim to regulate the conditions, procedures, activities and work of legal and natural persons that provide services and activities in the private security field.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 2</b> <b>Scope</b></p> <p>1. The provisions of this Law shall apply to relevant bodies in the field of private security services as well as other natural and legal persons whose activity is related to Private Security Services.</p>	<p><b>Skupština Republike Kosovo,</b></p> <p>Na osnovu Člana 65 (1) Ustava Republike Kosova,</p> <p>Usvaja:</p> <p><b>ZAKON O USLUGAMA PRIVATNOG OBEZBEĐENJA</b></p> <p><b>POGLAVLJE I</b> <b>OPŠTE ODREDBE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 1</b> <b>Svrha</b></p> <p>Ovaj zakon ima za cilj da reguliše uslove, postupke, aktivnosti i delatnost pravnih i fizičkih lica koji pružaju usluge i aktivnosti u oblasti privatnog obezbeđenja.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 2</b> <b>Delokrug</b></p> <p>1. Odredbe ovog zakona su obavezne za relevantne organe u oblasti usluga privatnog obezbeđenja, kao i za druga fizička i pravna lica čija se delatnost nadovezuje sa uslugama privatnog obezbeđenja.</p>
--	--	---

<p>2. Kushtet e punës për punëtorët e sigurimit, rregullohen me legjislacionin e zbatueshëm të punës.</p>	<p>2. Working conditions for Security Workers shall be regulated by the applicable legislation on labour.</p>	<p>2. Uslovi rada za radnike obezbeđenja regulišu se sa sprovodljivim zakonodavstvom o radu.</p>
<p><b>Neni 3 Përkufizimet</b></p>	<p><b>Article 3 Definitions</b></p>	<p><b>Član 3 Definicije</b></p>
<p>1. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:</p>	<p>1. The expressions, terms and acronyms used in this Law shall have the following meaning:</p>	<p>1. Izrazi, termini i skraćenice korišćene u ovom zakonu imaju ovo značenje:</p>
<p>1.1. <b>Aplikues</b> – nënkupton personin juridik të regjistruar si shoqëri tregtare që aplikon për leje, njoftim për fillimin e veprimtarisë, kartelë zyrtare identifikimi, certifikim ose ricertifikim nga organi kompetent;</p>	<p>1.1. <b>Applicant</b> – shall mean a legal person registered as a commercial company applying for a licence, notice of activity starting, official identity card, certification or recertification by the competent body;</p>	<p>1.1. <b>Aplikant</b> - podrazumeva pravno lice, registrovano kao privredno društvo koja aplicira za dozvolu, obaveštenje o početku delatnosti, službenu karticu identifikacije, sertifikaciju ili ponovnu sertifikaciju od nadležnog organa;</p>
<p>1.2. <b>Certifikim</b> – nënkupton pajisjen e personit fizik me certifikatë për secilin lloj të shërbimit të sigurimit privat, pas dhënies së provimit shtetëror përkatës të organizuar nga organi kompetent;</p>	<p>1.2. <b>Certification</b> – shall mean the equipment of the natural person with a certificate for any kind of private security services after passing the relevant state exam organised by the competent body;</p>	<p>1.2. <b>Sertifikacija</b> - podrazumeva opremanje fizičkog lica sertifikatom za svaku vrstu usluge privatnog obezbeđenja nakon polaganja odgovarajućeg državnog ispita organizovanog od nadležnog organa;</p>
<p>1.3. <b>Hapësirë e siguruar</b> – nënkupton hapësirën në të cilën kryhen shërbimet e sigurimit nga ata që posedojnë leje sipas këtij ligji;</p>	<p>1.3. <b>Secure area</b> – shall mean an area where security services are carried out by those who possess a licence according to this law;</p>	<p>1.3. <b>Obezbedeni prostor</b> - podrazumeva prostor u kome se obavljaju usluge obezbeđenja od onih koji poseduju dozvolu prema ovom zakonu;</p>
<p>1.4. <b>Instruktor për shërbimet private të sigurisë</b> – nënkupton personin fizik, i cili është certifikuar dhe është autorizuar nga</p>	<p>1.4. <b>Instructor for private security services</b> – shall mean the natural person, who has been certified and authorized by</p>	<p>1.4. <b>Instruktor za usluge privatnog obezbeđenja</b>- podrazumeva fizičko lice koje je sertifikovano i ovlašćeno od</p>

<p>organi kompetent për trajnim të caktuar të kandidatëve në fushën private të sigurisë;</p> <p><b>1.5. Institucion trajnues në fushën private të sigurisë</b> – nënkupton personin juridik që i është dhënë leja nga organi kompetent për ofrimin e trajnimeve në fushën private të sigurisë;</p> <p><b>1.6. Kartelë e identifikimit</b> – nënkupton dokumentin me të cilin punëtori i sigurimit identifikohet si i autorizuar për të kryer detyrat e parapara me këtë ligj;</p> <p><b>1.7. Klient</b> – nënkupton personin fizik dhe/apo personin juridik, i cili hyn në marrëdhënie kontraktuale me kompaninë private të sigurimit;</p> <p><b>1.8. Kompani private e sigurimit</b> – nënkupton personin juridik që posedon leje nga organi kompetent për të ofruar shërbime private të sigurimit në pajtim me këtë ligj;</p> <p><b>1.9. Kontrollim me prekje</b> – nënkupton kontrollimin me prekje të personit që e kryen punëtori i sigurimit për sende të kundërligjshme apo të rrezikshme;</p>	<p>the competent body for specific training of candidates in the private security field;</p> <p><b>1.5. Training institution in the private field of security</b> –shall mean the legal entity that has been granted permission by the competent body to provide training in the private field of security</p> <p><b>1.6. Identity Card</b> – shall mean the document which identifies the security worker as authorised to perform the tasks provided by this law;</p> <p><b>1.7. Client</b> – shall mean the natural and/or legal person who enters into a contractual relationship with the private security company;</p> <p><b>1.8. Private Security Company</b> – shall mean the legal person with a licence issued by the competent body to provide private security services in line with this law;</p> <p><b>1.9. Pat-down search</b> – shall mean the pat-down search of a person conducted by a security worker for illegal or dangerous items;</p>	<p>nadležnog organa za posebnu obuku kandidata u oblasti privatnog obezbeđenja;</p> <p><b>1.5. Institucija za obuku iz oblasti privatnog obezbeđenja</b> - podrazumeva pravno lice kome je od nadležnog organa data dozvola za pružanje obuke u privatnoj oblasti obezbeđenja;</p> <p><b>1.6. Identifikaciona kartica</b> - podrazumeva dokument kojim se radnik obezbeđenja identifikuje kao ovlašćen za obavljanje dužnosti predviđenih ovim zakonom;</p> <p><b>1.7. Klijent</b> - podrazumeva fizičko i/ili pravno lice koje stupa u ugovorni odnos sa privatnom kompanijom obezbeđenja;</p> <p><b>1.8. Privatna kompanija obezbeđenja</b> - podrazumeva pravno lice koje poseduje dozvolu od nadležnog organa za pružanje usluga privatnog obezbeđenja u skladu sa ovim zakonom;</p> <p><b>1.9. Kontrola dodirom</b> – podrazumeva kontrolu dodirom osobe koju vrši radnik obezbeđenja za ilegalne ili opasne predmete</p>
---	---	--

<p>1.10. <b>Leje</b> - nënkupton pajisjen me leje të personit juridik për ofrimin e shërbimeve private të sigurisë në fusha të caktuara të sigurisë, ashtu siç specifikohet me këtë ligj;</p> <p>1.11. <b>Mbajtës i qenit</b> – nënkupton punëtorin e specializuar të sigurimit, i cili është i autorizuar me kartelë të identifikimit që të kryejë detyrat sipas këtij ligji të lidhura me përdorimin e qenit;</p> <p>1.12. <b>Menaxher i sigurimit</b> – nënkupton punëtorin e specializuar të sigurimit, i autorizuar nga organi kompetent me kartelë të identifikimit, i cili është përgjegjës për udhëheqjen e shërbimit përkatës të sigurimit dhe menaxhimin e punëtorëve të sigurimit, sipas këtij ligji;</p> <p>1.13. <b>Ministria</b> - nënkupton Ministrinë përgjegjëse për Punë të Brendshme;</p> <p>1.14. <b>Ministri</b> - nënkupton Ministrin e Ministrisë përgjegjëse për Punë të Brendshme;</p> <p>1.15. <b>Njoftim për fillimin e veprimtarisë</b> - nënkupton njoftimin që lëshohet nga organi kompetent për ata që posedojnë leje për ofrimin e shërbimeve private të sigurisë,</p>	<p>1.10. <b>Licence</b> – shall mean the licence issued to a legal person to provide private security services in specific security fields, as specified by this law;</p> <p>1.11. <b>Dog handler</b> – shall mean a specialized security worker, authorised by an identity card to perform the tasks, according to this law, related to the use of dog;</p> <p>1.12. <b>Security Manager</b> – shall mean the specialised security worker authorised by the competent body with an identity card who is responsible for leading the relevant security service and managing security workers, in accordance with this law;</p> <p>1.13. <b>Ministry</b> – shall mean the Ministry responsible for Internal Affairs;</p> <p>1.14. <b>Minister</b>- shall mean the Minister of the Ministry in charge for Internal Affairs;</p> <p>1.15. <b>Notification for the start of activity</b> - means the notification issued by the competent body to those who have a permit for the provision of private security</p>	<p>1.10. <b>Dozvola</b> - podrazumeva opremanje dozvolom pravnog lica za pružanje usluga privatnog obezbeđenja u određenim oblastima bezbednosti, onako kao što se specifikuje ovim zakonom;</p> <p>1.11. <b>Čuvar pasa</b> - podrazumeva specijalizovanog radnika obezbeđenja, koji je ovlašćen identifikacionom karticom da obavlja obaveze prema ovom zakonu u vezi sa psom;</p> <p>1.12. <b>Menadžer obezbeđenja</b> - podrazumeva specijalizovanog radnika obezbeđenja, ovlašćen od nadležnog organa sa identifikacionom kartom, koji je odgovoran za rukovođenje odgovarajuće usluge obezbeđenja i upravljanje radnicima obezbeđenja, prema ovom zakonu;</p> <p>1.13. <b>Ministarstvo</b> - podrazumeva ministarstvo odgovorno za unutrašnje poslove;</p> <p>1.14. <b>Ministar</b> - podrazumeva ministar Ministarstva nadležan za unutrašnje poslove;</p> <p>1.15. <b>Obaveštenje o početku delatnosti</b> - podrazumeva obaveštenje izdato od strane nadležnog organa onima koji imaju dozvolu za pružanje usluga privatnog obezbeđenja,</p>
--	---	--

<p>për çdo marrëdhënie kontraktuale me klientin e tyre;</p> <p><b>1.16. Operator i mbikëqyrjes elektronike</b> – nënkupton punëtorin e specializuar të sigurimit, i autorizuar nga organi kompetent për të kryer shërbime të sigurimit në fushën e vëzhgimit elektronik të pronës nga Qendra e Kontrollit;</p> <p><b>1.17. Operator i Mbrojtjes së Afërt apo OMA</b> – nënkupton punëtorin e specializuar të sigurimit, i autorizuar me kartelë të identifikimit për të punuar në fushën e mbrojtjes së afërt;</p> <p><b>1.18. Pajisje e sigurimit</b> – nënkupton pajisjen që është lejuar nga organi kompetent;</p> <p><b>1.19. Përfaqësuesi i autorizuar</b> – nënkupton personin fizik, i cili autorizohet sipas legjislacionit të zbatueshëm për të vepruar në emër të aplikuesit ose poseduesit të lejes në fushën private të sigurisë;</p> <p><b>1.20. Personi që sigurohet</b> – nënkupton personin fizik të cilit i ofrohet mbrojtje e afërt nga kompania private e sigurimit, në pajtim me dispozitat e këtij ligji;</p>	<p>services, for any contractual relationship with their client;</p> <p><b>1.16. Electronic Surveillance Operator</b> – shall mean a specialised security worker, authorised by the competent body who performs security services in the field of electronic property surveillance from a Control Centre.</p> <p><b>1.17. Close Protection Operator (CPO)</b> – shall mean a specialist security worker, authorised by an identity card to work in the field of close protection;</p> <p><b>1.18. Security equipment</b> – shall mean the equipment that has been allowed by the competent body;</p> <p><b>1.19. Authorised representative</b> – shall mean a natural person who is authorised according to the applicable legislation to act on behalf of the applicant or holder of licence in the field of private security;</p> <p><b>1.20. Secured person</b> – shall mean a natural person to whom close protection is provided by a private security company in line with the provisions of this law;</p>	<p>za svaki ugovorni odnos sa svojim klijentom;</p> <p><b>1.16. Operator elektronskog nadzora</b> – je specijalizovani radnik obezbeđenja, ovlašćen od nadležnog organa, koji vrši usluge obezbeđenja u oblasti elektronskog nadzora imovine iz Kontrolnog centra;</p> <p><b>1.17. Operater bliske zaštite ili OBZ</b> - podrazumeva specijalizovanog radnika obezbeđenja, ovlašćen identifikacionom kartom da radi u oblasti bliske zaštite;</p> <p><b>1.18. Oprema obezbeđenja</b> – podrazumeva oprema koja je dozvoljena od nadležnog organa;</p> <p><b>1.19. Ovlašćeni predstavnik</b> – podrazumeva fizičko lice, koje je prema sprovođljivim zakonodavstvom ovlašćeno da deluje u ime podnosioca zahteva ili imaoca dozvole u privatnoj oblasti obezbeđenja;</p> <p><b>1.20. Lice koje se obezbeđuje</b> - podrazumeva fizičko lice kome se pruža bliska zaštita od privatnu kompaniju obezbeđenja, u skladu sa odredbama ovog zakona;</p>
--	--	---

<p>1.21. <b>Përdorimi i forcës</b> – nënkupton përdorimin e forcës fizike proporcionale me nivelin e kërcënimit nga ana e punëtorit të sigurimit, si dhe hapat gjatë përdorimit të forcës fizike kundër personit që reziston në një situatë të caktuar;</p> <p>1.22. <b>Plani i sigurisë</b> – nënkupton dokumentin që përcakton qëllimin, formën dhe metodën e ofrimit të sigurisë nga poseduesi i lejes përmes personelit të sigurimit;</p> <p>1.23. <b>Punëtor i sigurimit</b> – nënkupton punëtorin e sigurimit themelor ose punëtori i specializuar i sigurimit:</p> <p>1.23.1. <b>Punëtor i sigurimit themelor</b> – nënkupton personin e autorizuar me kartelë të identifikimit, të lëshuar nga organi kompetent për kryerjen e shërbimeve themelore të sigurimit;</p> <p>1.23.2. <b>Punëtor i specializuar i sigurimit</b> – nënkupton personin e autorizuar me kartelë të identifikimit të lëshuar nga organi kompetent që është i specializuar në një shërbim përkatës sipas këtij ligji;</p>	<p>1.21. <b>Use of force</b> – shall mean the use of physical force by the security worker proportionate to the level of threat as well as the steps taken during the use of physical force against a resisting person in a specific situation;</p> <p>1.22. <b>Security Plan</b> – shall mean the document defining the purpose, form and method of providing security by the holder of licence through the security staff;</p> <p>1.23. <b>Security Worker</b> – shall mean a basic security worker or specialist security worker:</p> <p>1.23.1. <b>Basic Security Worker</b> – shall mean an authorised person with an identity card issued by the competent body for the performance of basic security services;</p> <p>1.23.2. <b>Specialist Security Worker</b> – shall mean a person authorised by an identity card issued by the competent body who is specialised in a relevant service according to this law;</p>	<p>1.21. <b>Upotreba sile</b> - podrazumeva upotrebu fizičke sile proporcijalne nivooom pretnje od strane radnika obezbeđenja, kao i korake tokom upotrebe fizičke sile protiv lica koje pruža otpor u određenoj situaciji;</p> <p>1.22. <b>Plan obezbeđenja</b> - podrazumeva dokument koji utvrđuje svrhu, oblik i metodu pružanja obezbeđenja od posedioca dozvole kroz osoblje obezbeđenja;</p> <p>1.23. <b>Radnik obezbeđenja</b> – podrazumeva radnik osnovnog obezbeđenja ili specijalizovanog radnika obezbeđenja:</p> <p>1.23.1. <b>Radnik osnovnog obezbeđenja</b>–podrazumeva ovlašćeno lice sa identifikacionom kartom, izdatom od nadležnog organa za obavljanje osnovnih usluga obezbeđenja;</p> <p>1.23.2. <b>Specijalizovani radnik obezbeđenja</b>–podrazumeva lice ovlašćeno sa identifikacionom karticom izdatom od nadležnog organa koji je specijalizovan za odgovarajuću službu u skladu sa ovim zakonom;</p>
---	--	---

<p>1.24. <b>Qendër e Kontrollit</b> – nënkupton objektin nga i cili mbikëqyren, regjistrohen, koordinohen dhe mbështeten të gjitha aktivitetet, informatat dhe raportet prej punëtorëve të sigurimit;</p> <p>1.25. <b>Qen i sigurimit</b> – nënkupton qenin e trajnuar posaçërisht për të ruajtur pronën;</p> <p>1.26. <b>Roje e Transportit të Parave të Gatshme apo roje e TPG-së</b> – nënkupton punëtorin e specializuar të sigurimit, i autorizuar me kartelë zyrtare të identifikimit në fushën e shërbimit të TPG-së;</p> <p>1.27. <b>Shërbim i mbrojtjes së afërt</b> – nënkupton ofrimin e sigurisë fizike, ruajtjen dhe krijimin e hapësirës së sigurt për personin fizik që dëshiron të sigurohet;</p> <p>1.28. <b>Shërbim privat i sigurisë</b> – nënkupton shërbimin e ofruar nga personat juridikë të pajisur me leje përkatëse për ofrimin e shërbimeve private të sigurisë me qëllim të mbrojtjes së personave dhe pasurisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve të tjera relevante;</p> <p>1.29. <b>Shërbim i sigurimit të brendshëm apo vetanak</b> - nënkupton shërbimin themelor të sigurimit, të cilin e ofron</p>	<p>1.24. <b>Control Centre</b> – shall mean the facility from which all activities, information and reports from security workers are monitored, recorded, coordinated and supported;</p> <p>1.25. <b>Security dog</b> – shall mean a dog specially trained to guard property;</p> <p>1.26. <b>Cash-in-Transit Guard (CIT Guard)</b> – shall mean a specialist security worker authorised with an official identity card in the field of CIT services;</p> <p>1.27. <b>Close Protection Service</b> – shall mean a provision of physical security, protecting and creating a safe space for a natural person who wishes to be secured;</p> <p>1.28. <b>Private Security Service</b> – shall mean a service provided by legal persons equipped with the relevant licence for the provision of private security services with the aim of protecting people and property, in accordance with the provisions of this law and other relevant laws;</p> <p>1.29. <b>Internal or personal private insurance service</b> - means the basic insurance service, which is offered by the</p>	<p>1.24. <b>Kontrolni centar</b>–podrazumeva objekat sa kojeg se nadziru, registruju, koordiniraju i podržavaju sve aktivnosti, informacije i izveštaji od radnika obezbeđenja;</p> <p>1.25. <b>Pas obezbeđenja</b>–podrazumeva pas posebno obučen za čuvanje imovine;</p> <p>1.26. <b>Čuvar transporta gotovine ili TG čuvar</b>–podrazumeva specijalizirani radnik obezbeđenja, ovlašćen službenom identifikacionom kartom u oblasti usluge TG-a.</p> <p>1.27. <b>Usluga bliske zaštite</b> - pružanje fizičkog obezbeđenja, čuvanje i stvaranje bezbednog prostora za fizičko lice koje se želi obezbediti;</p> <p>1.28. <b>Privatna usluga obezbeđenja</b> - podrazumeva uslugu pruženu od pravnih lica opremljenih odgovarajućom dozvolom za pružanje usluga privatnog obezbeđenja, u cilju zaštite lica i imovine, u skladu sa odredbama ovog zakona i drugih relevantnih zakona;</p> <p>1.29. <b>Unutrašnja ili soptsvene usluga za obezbeđenje</b> - podrazumeva osnovnu uslugu obezbeđenja koju nudi pravno lice</p>
--	---	---



<p>personi juridik i regjistruar si shoqëri tregtare në objektet dhe zonat e destinuara vetëm për nevojat e tij, për sigurim të brendshëm, pa të drejtë të shitjes së shërbimit;</p> <p><b>1.30. Shërbim i sigurimit për infrastrukturë kritike</b> – nënkupton shërbimin e sigurimit, i cili ofrohet nga kompania private e sigurimit për sigurimin e infrastrukturës kritike, përmes punëtorëve të sigurimit të autorizuar, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me këtë ligj dhe me legjislacionin përkatës;</p> <p><b>1.31. Shërbim i sigurimit të ngjarjeve publike</b> – nënkupton shërbimin e kontrollimit të hyrjes dhe daljes së pjesëmarrësve në ngjarje publike, sigurimin e mbarëvajtjes dhe rendit në hapësirën e caktuar të ngjarjes publike;</p> <p><b>1.32. Shërbim themelor i sigurimit</b> – nënkupton ruajtjen statike dhe të lëvizshme, përmes punëtorëve të sigurimit për mbrojtje fizike të pronës, ose të hapësirës së siguruar;</p> <p><b>1.33. Shërbim i Transportit të Parave të Gatshme dhe sendeve me vlerë apo shërbimi i TPG-së</b> – nënkupton shërbimin që ofrohet nga kompania private e sigurimit, e pajisur me leje për shërbimin, sigurimin,</p>	<p>legal person registered as a commercial company, in the facilities and areas intended only for its internal insurance needs without the right to sell the service;</p> <p><b>1.30. Insurance service for critical infrastructure</b> –shall mean the insurance service, which is provided by the private insurance company for the insurance of critical infrastructure, through authorized insurance workers, according to the conditions and criteria defined under this law and the relevant legislation</p> <p><b>1.31. Public events security service</b> – shall mean the control service of entry and exit of participants in public events, ensuring smooth running and order in the designated area of the public event;</p> <p><b>1.32. Basic Security Service</b> – shall mean the static and mobile guarding through physical protection security workers or a secure area;</p> <p><b>1.33. Cash-in-Transit Service or transit of valuables service (CIT Service)</b> – shall mean the service provided by a private security company licenced to serve, secure,</p>	<p>registrovano kao privredno društvo, u objektima i područjima namenjenim samo za njegove potrebe za unutrašnje obezbeđenje bez prava prodaje usluge;</p> <p><b>1.30. Usluga obezbeđenja za kritičnu infrastrukturu</b> –podrazumeva usluga obezbeđenja koja se pruža od privatne kompanije obezbeđenja za obezbeđenje kritične infrastrukture, kroz ovlašćenih radnika obezbeđenja, prema uslovima i kriterijumima utvrđenim ovim zakonom i odgovarajućim zakonodavstvom;</p> <p><b>1.31. Usluga obezbeđenja javnih događaja</b> - podrazumeva uslugu kontrole ulaska i izlaska učesnika u javnim događajima, obezbeđenja nesmetanog odvijanja i reda u određenoj prostoriji javnih događaja;</p> <p><b>1.32. Osnovna usluga obezbeđenja</b> - podrazumeva statično i pokretno čuvanje kroz radnike obezbeđenja za fizičku zaštitu imovine ili obezbeđenog prostora;</p> <p><b>1.33. Usluga transporta novca i dragocenih stvari ili usluga TG -a</b> - podrazumeva uslugu koja se pruža od privatne kompanije obezbeđenja, opremljene dozvolom za uslugu,</p>
---	---	--

<p>përcjelljen gjatë marrjes, transportit dhe dorëzimit të parave të gatshme dhe sendeve me vlerë;</p> <p>1.34. <b>Shërbim i vëzhgimit elektronik të pronës</b> – nënkupton ofrimin e vëzhgimit elektronik të hapësirës dhe pronës së siguruar nga kompania private e sigurimit, në pajtim me këtë ligj;</p> <p>1.35. <b>Sistemi për Shërbimet Private të Sigurisë apo SShPS</b>–nënkupton sistem <i>online</i> të shfrytëzuar nga aplikuesit e shërbimeve private të sigurisë.</p>	<p>and escort the receipt, transport and delivery of cash and valuables;</p> <p>1.34. <b>Electronic Property Surveillance Service</b> – shall mean providing electronic surveillance of a secure area and property by a private security company in accordance with this law;</p> <p>1.35. <b>Private Security Service System (PSSS)</b> – shall mean the <i>online system used by the</i> applicants of private security services.</p>	<p>obezbeđenje, praćenje tokom prijema, transporta i dostave gotovine i dragocenih stvari;</p> <p>1.34. <b>Usluga elektronskog nadzora imovine</b> - podrazumeva pružanje elektronskog nadzora prostora i imovine obezbeđene od privatne kompanije obezbeđenja u skladu sa ovim zakonom;</p> <p>1.35. <b>Sistem za privatne usluge obezbeđenja ili SPUO</b> –podrazumeva onlajn sistem za primenu usluga privatnog obezbeđenja.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b> <b>Shërbimet private të sigurimit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 4</b> <b>Private Security Services</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 4</b> <b>Usluge privatnog obezbeđenja</b></p>
<p>1. Shërbimet private të sigurimit ofrohen vetëm nga poseduesi i lejes dhe njoftimit për fillimin e veprimtarisë, lëshuar nga organi kompetent, në pajtim me këtë ligj.</p> <p>2. Shërbimi i sigurimit të brendshëm mbulon vetëm nevojat e brendshme, pa të drejtë të shitjes së shërbimit të sigurimit për të tjerët, në pajtim me këtë ligj.</p> <p>3. Shërbimet private të sigurimit ushtrohen vetëm përmes punëtorëve të sigurimit të autorizuar me kartela të identifikimit, të</p>	<p>1. Private Security Services shall be provided only by the licensed provider and upon notification of starting the activity issued by the competent body, in accordance with this Law.</p> <p>2. The Internal Security Service shall cover internal needs, without a right to sell the security service to others, in line with this Law.</p> <p>3. Private Security Services shall be provided only through security workers authorised with identity cards approved by the Competent Body, in line with this Law.</p>	<p>1. Usluge privatnog obezbeđenja pružaju se samo posediocu dozvole i obaveštenja za početak delatnosti izdato od strane nadležnog organa u skladu sa ovim zakonom.</p> <p>2. Usluga unutrašnjeg obezbeđenja pokriva samo unutrašnje potrebe, bez prava prodaje usluge obezbeđenja za druge, u skladu sa ovim zakonom.</p> <p>3. Usluge privatnog obezbeđenja vrše se samo kroz ovlašćenih radnika obezbeđenja sa identifikacionom kartom odobrenom od nadležnog organa, u skladu sa ovim zakonom.</p>

<p>aprovuara nga organi kompetent, në pajtim me këtë ligj.</p> <p>4. Para ofrimit të shërbimit privat të sigurisë kompania private e sigurimit që posedon leje, sipas llojit të ofrimit të shërbimeve në pajtim me këtë ligj, duhet të lidhë kontratë me shkrim me klientin që të ofrojë shërbime të sigurisë, duke treguar në mënyrë të qartë formën dhe qëllimin e ofrimit të shërbimit të sigurisë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Kompania e huaj e sigurimit</b></p> <p>1. Personi juridik nga vendi i huaj, i cili posedon leje në vendin e tij të origjinës për të ofruar shërbime private të sigurisë, mund të aplikojë për tu pajisur me leje në Republikën e Kosovës, nëse plotëson kriteret e njëjta sikurse aplikuesi vendor në pajtim me këtë ligj.</p> <p>2. Lejet e huaja ofrohen në gjuhën e tyre origjinale dhe të përkthyer në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Shtetasi i huaj gëzon të drejtën të certifikohet dhe të pajiset me kartelë zyrtare të identifikimit, të aprovuar nga organi kompetent si punëtor i sigurimit, nëse i plotëson kriteret e përcaktuara me këtë ligj, kriteret e tjera të përcaktuara me legjislacionin përkatës për të huajt dhe të këtë</p>	<p>4. Before providing Private Security Services, the Private Security Company licensed according to the type of service provision in accordance with this Law, shall enter into a written contract with the client to provide security services, clearly indicating the form and purpose of providing security services.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>Foreign Security Companies</b></p> <p>1. Legal persons from foreign countries shall, licensed in their country of origin to provide private security services, be eligible to apply for licensing in the Republic of Kosovo if they meet the same criteria as national applicants in accordance with this Law.</p> <p>2. Foreign licences shall be provided in their original language and shall be translated into official languages of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. Foreign citizens shall enjoy the right to be certified and provided with an official identification card approved by the competent body as security worker if they meet the criteria defined by this law, other criteria defined by the relevant legislation on foreigners and has</p>	<p>4. Pre pružanja usluge privatnog obezbeđenja, privatna kompanija obezbeđenja koja poseduje dozvolu prema vrsti pružanja usluga u skladu sa ovim zakonom, mora da sklopi pismeni ugovor sa klijentom da bi pružala usluge obezbeđenja, navodeći jasan način oblik i svrhu pružanja usluge obezbeđenja.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 5</b> <b>Strana kompanija obezbeđenja</b></p> <p>1. Pravno lice iz strane zemlje, koje poseduje dozvolu u svojoj zemlji porekla za pružanje privatnih usluga obezbeđenja može aplicirati da bi se opremilo dozvolom u Republici Kosovo, ako ispunjava iste kriterijume kao i domaći aplikant u skladu sa ovim zakonom.</p> <p>2. Strane dozvole se pružaju na njihovom originalnom jeziku i prevedene na službene jezike Republike Kosova.</p> <p>3. Strani državljanin uživa pravo da se sertifikuje i opremi službenom identifikacionom kartom odobrenom od nadležnog organa kao radnik obezbeđenja, ako ispunjava kriterijume utvrđene ovim zakonom, druge kriterijume utvrđene odgovarajućim zakonodavstvom za strance i da ima</p>
---	---	---

<p>njohuri elementare të njërës nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p>4. Kompania e huaj e sigurimit sipas këtij neni nuk mund të aplikojë për t'u pajisur me leje për ofrimin e shërbimit të sigurisë sipas nenit 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Llojet e shërbimeve private të sigurisë</b></p> <p>1. Llojet e shërbimeve private të sigurisë janë si në vijim:</p> <p>1.1. shërbimi themelor i sigurimit;</p> <p>1.2. shërbimi i mbrojtjes së afërt;</p> <p>1.3. shërbimi i transportit të parave të gatshme dhe sendeve me vlerë;</p> <p>1.4. shërbimi i vëzhgimit elektronik të pronës;</p> <p>1.5. shërbimi i sigurimit të ngjarjeve publike;</p> <p>1.6. shërbimi i sigurimit për infrastrukturë kritike.</p>	<p>elementary knowledge of one of the official languages of the Republic of Kosovo.</p> <p>4. According to this article, the foreign insurance company cannot apply for a licence for the provision of security services according to article 6, paragraph 1, sub-paragraph 1.6 of this law.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Types of Private Security Services</b></p> <p>1. The types of Private Security Services are as follows:</p> <p>1.1. basic Security Services;</p> <p>1.2. close Protection Services;</p> <p>1.3. cash-in-Transit and valuables transport services;</p> <p>1.4. electronic Property Surveillance Services;</p> <p>1.5. public events security services;</p> <p>1.6. security Services for Critical Infrastructure.</p>	<p>elementarna znanja jednog od službenih jezika Republike Kosova.</p> <p>4. Prema ovom članu, strano društvo za obezbeđenje ne može podneti zahtev za dobijanje dozvole za pružanje usluga obezbeđenja u skladu sa članom 6 stav 1 tačka 1.6 ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Vrste usluga privatnog obezbeđenja</b></p> <p>1. Vrste usluga privatnog obezbeđenja su, kao u nastavku:</p> <p>1.1. osnovna usluga obezbeđenja;</p> <p>1.2. usluga bliske zaštite;</p> <p>1.3. usluga transporta gotovine i dragocenih stvari;</p> <p>1.4. usluga elektronskog nadzora imovine;</p> <p>1.5. usluga obezbeđenja javnih događaja;</p> <p>1.6. usluga obezbeđenja kritične infrastrukture.</p>
--	--	--

<b>KAPITULLI II ORGANI KOMPETENT</b>	<b>CHAPTER II COMPETENT BODY</b>	<b>POGLAVLJE II NADLEŽNI ORGAN</b>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 7 Organi kompetent</b></p> <p>1.Organ kompetent është Ministria përgjegjëse për Punë të Brendshme.</p> <p>2.Njësia përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, përcaktohet nga organi kompetent në pajtim me rregullat e organizimit të brendshëm.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 7 Competent Body</b></p> <p>1. The Competent Body shall be the Ministry responsible for Internal Affairs.</p> <p>2. The responsible unit for the implementation of this law shall be appointed by the competent body in line with the rules of internal organisation.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 7 Nadležni organ</b></p> <p>1. Nadležni organ je Ministarstvo odgovorno za unutrašnje poslove.</p> <p>2. Jedinica odgovorna za sprovođenje ovog zakona utvrđuje se od nadležnog organa u skladu sa pravilima unutrašnje organizacije.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 8 Kompetencat e organit kompetent</b></p> <p>1.Organi kompetent ka këto kompetenca:</p> <p>1.1. kryen funksionet lidhur me lëshimin e lejeve, certifikimin, ricertifikimin dhe njoftimet e përcaktuara me këtë ligj;</p> <p>1.2. kryen monitorimin e aktiviteteve të kompanive private të sigurimit;</p> <p>1.3. kryen inspektimin e aktiviteteve të kompanive private të sigurimit, punëtorëve të sigurimit dhe ndaj atyre që ushtrojnë</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 8 Competencies of the Competent Body</b></p> <p>1. The Competent Body shall have the following competencies:</p> <p>1.1. Carrying out functions related to licensing, certification, recertification and notices defined by this law;</p> <p>1.2. Monitoring the activities of private security companies;</p> <p>1.3. Performing inspections of activities of private security companies, security workers, and those who practice the private security activity to implement this law.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 8 Nadležnosti Nadležnog organa</b></p> <p>1. Nadležni organ ima ove nadležnosti:</p> <p>1.1. obavlja funkcije u vezi sa izdavanjem dozvola, sertifikacijom, ponovnom sertifikacijom i obaveštavanjima utvrđenim ovim zakonom;</p> <p>1.2. obavlja nadzor aktivnosti privatnih kompanija obezbeđenja;</p> <p>1.3. obavlja inspekciju aktivnosti privatnih kompanija obezbeđenja, radnika obezbeđenja i prema onima koji vrše</p>

<p>veprimtarinë private të sigurimit për të zbatuar këtë ligj.</p> <p>1.4. bën rekomandime, propozime, vërejtje dhe ndërmerr masa shtesë për ruajtjen dhe ngritjen e nivelit të sigurisë private;</p> <p>1.5. lëshon, vazhdon, pezullon, apo revokon lejen dhe/apo kartelën e identifikimit;</p> <p>1.6. shqipton dënimet me gjobë në pajtim me këtë ligj;</p> <p>1.7. bën aprovimin e kartelave të identifikimit dhe evidentimin për punëtorët e sigurimit, ata që posedojnë leje dhe subjektet e tjera që kryejnë shërbime private të sigurisë, siç është përcaktuar me këtë ligj;</p> <p>1.8. menaxhon sistemin elektronik për Shërbimet Private të Sigurisë;</p> <p>1.9. organizon provim shtetëror për certifikim të punëtorëve të sigurimit, në pajtim me këtë ligj;</p> <p>1.10. mban evidencën, si dhe dërgon dhe përditëson në përputhje me legjislacionin në fuqi për leje dhe licenca të dhënat për lejet e lëshuara sipas këtij ligji;</p>	<p>1.4. Making recommendations, proposals, remarks, and undertakes additional measures for the maintenance and improvement of the private security level;</p> <p>1.5. Issuing, extending, suspending, or revoking licence and/or identity card;</p> <p>1.6. Imposing fines in accordance with this law;</p> <p>1.7. Approving identity cards and record security workers, those who are licenced, and other entities providing private security services, as defined by this law;</p> <p>1.8. Managing the electronic Private Security Service system;</p> <p>1.9. Organising the national certification examination for security workers in line with this law;</p> <p>1.10. Maintaining the evidence, sends and updates in accordance with the applicable legislation in all the data on the licences issued according to this law;</p>	<p>privatnu delatnost obezbeđenja za sprovođenje ovog zakona.</p> <p>1.4. daje preporuke, predloge, primedbe i preduzima dodatne mere za čuvanje i podizanje nivoa privatne bezbednosti;</p> <p>1.5. izdaje, nastavlja, suspenduje, ili ukida dozvolu i/ili identifikacionu kartu;</p> <p>1.6. izriče novčane kazne u skladu sa ovim zakonom;</p> <p>1.7. vrši odobravanje identifikacionih karata i evidentiranje za radnike obezbeđenja, oni koji poseduju dozvole i drugi subjekti koji obavljaju privatne usluge obezbeđenja, kako je utvrđeno ovim zakonom;</p> <p>1.8. upravlja elektronskim sistemom za usluge privatnog obezbeđenja;</p> <p>1.9. organizuje državni ispit za sertifikaciju radnika obezbeđenja u skladu sa ovim zakonom;</p> <p>1.10. Vodi evidenciju i šalje na ažuriranje u skladu sa zakonodavstvom na snazi za elektronski registar za dozvole i lecenece i dozvole izdate u skladu sa ovim zakonom;</p>
--	---	--

<p>1.11. kryen detyra të tjera të përcaktuara me këtë ligji.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>E drejta e ankesës</b></p> <p>1. Kundër secilit vendim përfundimtar të nxjerrë sipas këtij ligji, lejohet ankesa në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.</p> <p>2. Organi epror që shqyrton ankesat sipas paragrafit 1 të këtij neni është Komisioni i Ankesave për Sigurinë Private, i themeluar me vendim të Ministrit.</p> <p>3. Ministri, me akt nënligjor përcakton përbërjen e komisionit dhe mandatin e anëtarëve të komisionit.</p>	<p>1.11. Perform other tasks defined under this law.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>The right to appeal</b></p> <p>1. Appeals shall be allowed against any final decision issued according to this law, in line with the rules defined by the relevant Law on General Administrative Procedure.</p> <p>2. The superior body that reviews the complaints referred to in paragraph 1 of this article is the Appeals Commission for Private Security established by the decision of the Minister.</p> <p>3. The Minister shall, by a bylaw, define the composition of the commission and the mandate of the commission members.</p>	<p>1.11. obavlja i druge obaveze definisane zakonom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Pravo na žalbu</b></p> <p>1. Protiv svake konačne odluke izdate prema ovom zakonu, dozvoljava se žalba u skladu sa pravilima utvrđenim odgovarajućim Zakonom o opštoj administrativnoj proceduri.</p> <p>2. Nadređeni organ koji razmatra žalbe prema stavu 1 ovog člana, je Komisija za žalbe za privatno obezbeđenje osnovana odlukom ministra.</p> <p>3. Ministar podzakonskim aktom utvrđuje sastav komisije i mandat članova komisije.</p>
<p><b>KAPITULLI III</b> <b>LEJET</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Lejet për shërbimet private të sigurisë</b></p> <p>1. Personi juridik, i cili është i regjistruar në regjistrin e bizneseve në Republikën e Kosovës, ka të drejtë të aplikojë për tu pajisur me leje për llojet e shërbimeve private të sigurisë, të listuara në nenin 6 të këtij ligji.</p>	<p><b>CHAPTER III</b> <b>LICENCES</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>Private Security Service Licences</b></p> <p>1. The legal person that is registered in the business register of the Republic of Kosovo shall have the right to apply for a licence for the types of Private Security Services listed in Article 6 of this Law.</p>	<p><b>POGLAVLJE III</b> <b>DOZVOLE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Dozvole za privatne usluge obezbeđenja</b></p> <p>1. Pravno lice koje je registrovano u registru biznisa u Republici Kosovo ima pravo da aplicira da bi se opremilo sa dozvolom za vrste usluga privatnog obezbeđenja navedene u članu 6 ovog Zakona.</p>

<p>2. Kushdo që vepron dhe ofron shërbime private të sigurisë, duhet të ketë lejen përkatëse të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.</p> <p>3. Aplikuesi duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara me këtë ligj para se t'i jepet leja për të ofruar shërbimin e sigurimit.</p> <p>4. Sipas këtij ligji, të gjitha lejet lëshohen për një periudhë pesë (5) vjeçare.</p> <p>5. Poseduesi i lejes duhet të aplikojë për vazhdim të lejes jo më herët se nëntëdhjetë (90) ditë para skadimit të afatit, dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para skadimit të afatit.</p> <p>6. Nëse organi kompetent refuzon kërkesën për vazhdim të lejes për arsye të mos plotësimin të kriterëve sipas këtij ligji, aplikuesi, të cilit i refuzohet kërkesa, obligohet që brenda tridhjetë (30) ditësh pas marrjes së vendimit të njoftojë klientët e tij për ndërprerje të kontratave.</p> <p>7. Çdo leje është e vlefshme vetëm për llojin e caktuar të shërbimit privat të sigurimit të caktuar në atë leje, sipas këtij ligji.</p> <p>8. Personave juridikë, të cilët merren me aktivitetet e industrisë së armëve, iu ndalohet të aplikojnë si kompani private e sigurimit.</p>	<p>2. Anyone who operates and provides private security services must have the relevant permit defined in paragraph 1 of this article.</p> <p>3. The applicants shall meet the conditions provided by this Law before they are granted a licence to provide security services.</p> <p>4. According to this Law, all licences shall be issued for a period of five (5) years.</p> <p>5. For licence extension, the licensee shall apply period not earlier than ninety (90) days before the expiration date and not later than thirty (30) days before the expiration date.</p> <p>6. If the Competent Body refuses the request for licence extension due to the applicant's failure to meet the criteria defined by this law, the applicant whose request is refused is obliged to inform their clients about the contract termination within a period of thirty (30) days.</p> <p>7. All licences shall be valid only for the specific type of private security service defined in that licence according to this Law.</p> <p>8. Legal entities working in activities of the arms industry shall be prohibited from applying as private security companies.</p>	<p>2. Ko god deluje i pruža usluge privatnog obezbeđenja, mora imati odgovarajuću dozvolu utvrđenu u stavu 1. ovog člana.</p> <p>3. Aplikant mora ispuniti uslove utvrđene ovim zakonom pre nego što mu se da dozvola da bi pružao usluge obezbeđenja.</p> <p>4. Prema ovom zakonu, sve dozvole se izdaju za period od pet (5) godina.</p> <p>5. Za produženje dozvole, posedioc dozvole mora aplicirati ne ranije od devedeset (90) dana pre isteka roka, i ne kasnije od trideset (30) dana pre isteka roka.</p> <p>6. Ako nadležni organ odbije zahtev za produženje licence iz razloga neispunjavanja kriterijuma prema ovom zakonu, aplikant kojem se zahtev odbije, obavezuje se da u roku od trideset (30) dana nakon primanja odluke obavesti svoje klijente o prekidu ugovora.</p> <p>7. Svaka dozvola je važeća samo za određenu vrstu usluge privatnog obezbeđenja određena u toj dozvoli prema ovom zakonu.</p> <p>8. Pravna lica koja se bave aktivnostima industrije oružja, zabranjuje im se da apliciraju kao privatna kompanija obezbeđenja.</p>
---	--	---



<p>9. Personat juridikë nga paragrafi 8 i këtij neni mund të aplikojnë për të marrë lejen për ofrimin e shërbimit të sigurimit të brendshëm.</p> <p>10. Ministri me akt nënligjor përcakton kushtet, kriteret dhe procedurën për lëshimin e lejes për ofrimin e shërbimeve private të sigurisë.</p>	<p>9. Legal entities referred to in paragraph 8 of this Article may apply to obtain a licence for the provision of internal security services.</p> <p>10. The Minister shall, by a bylaw, define the terms, conditions, and procedure of issuing licences for the provision of private security services.</p>	<p>9. Pravna lica iz stava 8. ovog člana, mogu aplicirati da dobiju dozvolu za pružanje usluge unutrašnjeg obezbeđenja.</p> <p>10. Ministarstvo podzakonskim aktom utvrđuje uslove, kriterijume i postupak za izdavanje dozvole za pružanje usluga privatnog obezbeđenja.</p>
<p><b>Neni 11</b> <b>Verifikimi i të kaluarës së aplikuesit</b></p>	<p><b>Article 11</b> <b>Background check of applicants</b></p>	<p><b>Član 11</b> <b>Verifikacija prošlosti aplikanta</b></p>
<p>1. Verifikimi i së kaluarës kryhet për çdo aplikues para lëshimit të lejes për secilin lloj të shërbimit privat të sigurimit, të përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji.</p> <p>2. Verifikimi i të kaluarës duhet të bëhet për aplikuesin, themeluesit, pronarët dhe personat përgjegjës të tij.</p> <p>3. Verifikimi i të kaluarës duhet të përsëritet nga organi kompetent para vazhdimin të lejes, në rastet e ndërrimit të pronarit, themeluesit dhe personit përgjegjës të tij dhe në çdo kohë nëse dyshon se personat sipas këtij paragrafi kanë kryer vepër penale.</p> <p>4. Verifikimi i të kaluarës për aplikuesin dhe personat e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, përfshin:</p>	<p>1. A background check shall be performed on all applicants before issuing a licence for any type of Private Security Services defined under Article 6 of this Law.</p> <p>2. A background check shall be performed for the applicant, founders, owners, and responsible persons.</p> <p>3. A background check shall be repeated by the competent body before the extension of a licence, in cases of the change of the owner, founder and responsible person, and at any time if it is suspected that the persons referred to in this paragraph have committed a criminal offence.</p> <p>4. A background check on the applicant and persons referred to in paragraph 2 of this Article shall include:</p>	<p>1. Verifikacija prošlosti će se obaviti za svakog aplikanta pre nego što mu se izda dozvola za svaku vrstu usluge privatnog obezbeđenja, utvrđenu u člana 6 ovog zakona.</p> <p>2. Verifikacija prošlosti mora se vršiti za aplikante, njegove osnivače, vlasnike i odgovorna lica.</p> <p>3. Verifikacija prošlosti mora se ponoviti od nadležnog oragana pre produženja dozvole, u slučajevima promene vlasnika, njegovog osnivača i odgovornog lica i u svakom vremenu, ako sumnja da su lica prema ovom stavu počinili krivično delo.</p> <p>4. Verifikacija prošlosti za aplikanta i lica utvrđena u stavu 2. ovog člana, obuhvata:</p>

<p>8. Ministri me akt nënligjor, përcakton kushtet dhe kriteret për njoftim për fillimin e veprimtarisë, formën e rregullores së brendshme dhe planin e sigurisë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 21</b> <b>Përgjegjësia e kompanisë private të sigurimit për kompensimin e dëmit dhe sigurimi i përgjegjësive</b></p> <p>1. Kompania private e sigurimit, ose poseduesi i lejes, para fillimit të veprimtarisë duhet të sigurohet ndaj përgjegjësive për kompensimin e dëmeve të cilat mund t'i shkaktohen klientit gjatë ushtrimit të shërbimeve private të sigurisë, apo personit të tretë në lidhje me sigurinë private.</p> <p>2. Kompanitë private të sigurimit duhet të posedojnë policën përkatëse të sigurimit, të lëshuar nga një kompani e sigurimeve e licencuar në Kosovë, e cila ofron mbulesë adekuate për kontratat e tyre të nënshkuara.</p> <p>3. Dëshmia për policën adekuate të sigurimit duhet t'i dorëzohet organit kompetent para marrjes së njoftimit për fillimin e veprimtarisë.</p> <p>4. Polica e sigurimit nga paragrafi 3 i këtij neni duhet të ripërtërihet dhe i nënshtrohet kontrollimeve të inspektorëve.</p>	<p>8. The Minister shall, by a bylaw, establish the conditions and criteria for notifying the commencement of activities, the form of internal regulations and the security plan.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 21</b> <b>Responsibility of Private Security Company for damage compensation of and liability insurance</b></p> <p>1. A Private Security Company or the Licensee shall, prior to commencing operations, be insured of the responsibility for compensation of damage that may be caused to the client while performing Private Security Services or third persons in connection with Private Security.</p> <p>2. Private Security Companies shall hold an adequate insurance policy issued by an insurance company licensed in Kosovo, which provides adequate coverage for their signed contracts at all times.</p> <p>3. Proof of an adequate insurance policy shall be submitted to the Competent Body prior to being granted the notification to commence operations.</p> <p>4. The insurance policy referred to in paragraph 3 of this Article shall be subject to renewal and inspectors` checks.</p>	<p>8. Ministar podzakonskim aktom utvrđuje uslove i kriterijume za obaveštavanje o početku delatnosti, oblik unutrašnjeg propisa i plan za obezbeđenje</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 21</b> <b>Odgovornost privatne kompanije obezbeđenja za naknadu štete i obezbeđenje odgovornosti</b></p> <p>1. Privatna kompanija ili posedioc dozvole pre početka delatnosti mora se obezbediti od odgovornosti za naknadu šteta koje se mogu prouzrokovati klijentu tokom vršenja usluga privatnog obezbeđenja, ili trećem licu u vezi sa privatnim obezbeđenjem.</p> <p>2. Privatne kompanije obezbeđenja moraju posedovati odgovarajuću polisu osiguranja, izdatu od kompaniju obezbeđenja licenciranu na Kosovu, koja pruža adekvatno pokriće za njihove potpisane ugovore.</p> <p>3. Dokaz o adekvatnoj polisi osiguranja, mora se dostaviti nadležnom organu pre prijema obaveštenja za početak delatnosti.</p> <p>4. Polisa osiguranja iz stava 3. ovog člana, treba da se obnovii podleže kontrolama inspektora.</p>
--	--	---

<p>5. Polica e sigurimit, me të dhënat e domosdoshme, duhet të përfshihet në kontratën, e cila lidhet në mes të kompanisë private të sigurimit dhe klientit të saj.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 22</b> <b>Kontrata në mes të kompanisë private të sigurimit dhe klientit</b></p> <p>1. Para ofrimit të shërbimit privat të sigurisë, poseduesi i lejes sipas llojit të shërbimeve në pajtim me këtë ligj, duhet të lidhë kontratë me shkrim me klientin që të ofrojë shërbime të sigurisë, duke treguar në mënyrë të qartë qëllimin dhe formën e ofrimit të shërbimit të sigurisë.</p> <p>2. Kontrata duhet të përmbajë së paku të dhënat si në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. emrin dhe adresën e klientit, i cili lidh marrëdhënie kontraktuale me poseduesin e lejes;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. emrin e kompanisë private të sigurimit, numrin e lejes dhe llojin e ofrimit të shërbimit privat të sigurisë;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3. datën e fillimit të shërbimit privat të sigurimit, kohën dhe kohëzgjatjen e kontratës dhe mbulimin e hapësirës së siguruar;</p>	<p>5. The insurance policy with the necessary data shall be included in the contract entered into between the Private Security Company and its client.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 22</b> <b>Contracts between the Private Security Company and the client</b></p> <p>1. Prior to providing a Private Security Service, the Licensee shall, depending on the type of service provided in accordance with this Law, enter into a written contract with the client in order to provide Security Services, clearly indicating the purpose and form of provision of the Security Service.</p> <p>2. The contract shall contain at least the following data:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. name and address of the client who has entered into a contractual relationship with the Licensee;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. name of the Private Security Company, licence number and type of the Private Security Service provided;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3. start date of the Private Security Service, duration of the contract and coverage of the secured area;</p>	<p>5. Polisa osiguranja sa neophodnim podacima mora se uključiti u ugovor, koji se sklapa između privatne kompanije obezbeđenja i njenog klijenta.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 22</b> <b>Ugovor između privatne kompanije obezbeđenja i klijenta</b></p> <p>1. Pre pružanja usluge privatnog obezbeđenja, posedioc dozvole prema vrsti pružanja usluga u skladu sa ovim zakonom mora da sklopi pismeni ugovor sa klijentom da bi pružao usluge obezbeđenja, pokazujući na jasan način svrhu i oblik pružanja usluge obezbeđenja.</p> <p>2. Ugovor mora sadržati najmanje podatke kao u nastavku:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. ime i adresu klijenta koji je sklopio ugovorni odnos sa posediocem dozvole;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. ime privatne kompanije obezbeđenja, broj dozvole i vrstu pružanja usluge privatnog obezbeđenja;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3. datum početka usluge privatnog obezbeđenja, vreme i trajanje ugovora i pokrivenost obezbeđenog područja;</p>
--	--	--

<p>2.4. numrin e punëtorëve të angazhuar të sigurimit.</p> <p><b>KAPITULLI IV MASAT, AUTORIZIMET DHE DETYRAT E PUNËTORËVE TË SIGURIMIT</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 23 Detyrimi për punëtorët e sigurimit</b></p> <p>Punëtori i sigurimit dhe të punësuarit në kompaninë private të sigurimit nuk lejohet të përdorin pije alkoolike dhe lëndë narkotike para dhe gjatë ushtrimit të shërbimeve private të sigurisë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 24 Papajtueshmëria në ushtrimin e detyrës</b></p> <p>Asnjë themelues, pronar, përfaqësues i autorizuar, punëtor sigurimi apo i punësuar tek poseduesi i lejes nuk mund të punësohet në të njëjtën kohë nga institucionet shtetërore të sigurisë si: Policia e Kosovës, Agjencia e Inteligjencës së Kosovës, Agjencia Pyjore e Kosovës, Shërbimi Korrektuese, Forca e Sigurisë së Kosovës dhe organi kompetent.</p>	<p>2.4. number of Security Workers engaged.</p> <p><b>CHAPTER IV MEASURES, AUTHORIZATIONS AND DUTIES OF SECURITY WORKERS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 23 Obligation for Security Workers</b></p> <p>A Security Worker and employees in the Private Security Company should not use alcoholic beverages and narcotic substances before and during the provision of Private Security Services.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 24 Incompatibility in the exercise of duty</b></p> <p>No founder, owner, authorised person, security worker, or employee with the licensee can be simultaneously employed by state security institutions, including: Kosovo Police, Kosovo Intelligence Agency, Kosovo Forest Agency, Correctional Service, Kosovo Security Force, and the Competent Authority.</p>	<p>2.4. broj angažovanih radnika obezbeđenja.</p> <p><b>POGLAVLJE IV MERE, OVLAŠĆENJA I DUŽNOSTI RADNIKA OBEZBEĐENJA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 23 Odgovornost radnika obezbeđenja</b></p> <p>Radnik obezbeđenja i zaposleni u privatnoj kompaniji obezbeđenju ne smeju koristiti alkoholna pića i narkotičke supstance pre i tokom vršenja usluga privatnih usluga obezbeđenja.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 24 Nekompatibilnost u vršenju dužnosti</b></p> <p>Nijedan osnivač, vlasnik, odgovorno lice, radnik obezbeđenja ili zaposleni kod posedioca dozvole ne može se istovremeno zaposliti od državne institucije obezbeđenja, uključujući: Policiju Kosova, Obaveštajnu agenciju Kosova, Agenciju za šume Kosova, Popravne službe, Kosovske bezbednosne snage i nadležnog organa.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 25</b> <b>Autorizimet dhe detyrat e poseduesve të lejes për ushtrimin e shërbimeve private të sigurisë</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 25</b> <b>Authorisations and duties of the Licensees for Private Security Services</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 25</b> <b>Ovlašćenja i dužnosti posedioca dozvole za vršenje usluga privatnog obezbeđenja</b></p>
<p>1. Poseduesi i lejes për shërbimet private të sigurisë duhet të kujdeset që punëtori i sigurimit kryen vetëm detyrën përkatëse, për të cilën është i autorizuar me kartelë të identifikimit.</p> <p>2. Poseduesi i lejes për shërbimet themelore të sigurimit ofron shërbimin e sigurimit vetëm në hapësirën e siguruar, objektin, pronën dhe personat në hapësirën e siguruar.</p> <p>3. Poseduesi i lejes për shërbimet e mbrojtjes së afërt ofron shërbimin për mbrojtjen e jetës së personit që sigurohet në hapësirat e caktuara, ose gjatë lëvizjes.</p> <p>4. Poseduesi i lejes për shërbimet private të sigurisë, për kryerjen e shërbimeve të mbrojtjes së afërt duhet të sigurojë që:</p> <p style="padding-left: 20px;">4.1. operatorët e mbrojtjes së afërt të jenë të pajisur me mjete që u mundësojnë komunikim të vazhdueshëm përmes radiolidhjeve me qendrën e tyre të kontrollit, dhe me njëri-tjetrin kur janë të caktuar në të njëjtën detyrë;</p>	<p>1. The Licensee for Private Security Services shall take care that the Security Worker only performs the task for which he is authorised by the Identification Card.</p> <p>2. The Licensee for Basic Security Services shall provide the Security Service in the secured area, facility, property and persons in the secured area.</p> <p>3. The Licensee for Close Protection Services shall provide protection of a Principal's life in designated areas or while on the move.</p> <p>4. In order for the Licensees for Private Security Services to perform Close Protection Services, they shall ensure that:</p> <p style="padding-left: 20px;">4.1. close Protection Operatives are equipped with devices that enable continuous communication through radio links with their Control Centre, and with each other when performing the same duty;</p>	<p>1. Posedioc dozvole za usluge privatnog obezbeđenja, mora da se brine da radnik obezbeđenja obavlja samo odgovarajuću dužnost za koju je ovlašćen sa identifikacionom kartom.</p> <p>2. Posedioc dozvole za osnovne usluge obezbeđenja pruža uslugu obezbeđenja samo u obezbeđenom prostoru, objektu, imovini i licima u obezbeđenom prostoru.</p> <p>3. Posedioc dozvole za usluge bliske zaštite pruža uslugu zaštite života lica koje se obezbedi, u određenim prostorima ili tokom kretanja.</p> <p>4. Posedioc dozvole za usluge privatnog obezbeđenja, za obavljanje usluga bliske zaštite, mora obezbediti da:</p> <p style="padding-left: 20px;">4.1. operateri bliske odbrane budu opremljeni sredstvima koja im omogućavaju kontinuiranu komunikaciju kroz radio veza sa svojim kontrolnim centrom, i jedni sa drugima kada su određeni na istu dužnost;</p>

<p>4.2. operatorët e mbrojtjes së afërt, të jenë të pajisur me pajisje të sigurimit dhe me armë zjarri në pajtim me këtë ligj dhe me ligjin përkatës për armë.</p> <p>5. Poseduesi i lejes për shërbimet e transportit të parave të gatshme, bën ruajtjen e parave të gatshme dhe sendeve tjera me vlerë gjatë marrjes, transportimit dhe dorëzimit me automjete të certifikuara nga organi kompetent.</p> <p>6. Poseduesi i lejes për shërbimet private të sigurisë, për kryerjen e shërbimeve të TPG-së, duhet të sigurojë që:</p> <p>6.1. rojet e TPG-së, janë të pajisur me mjete që iu mundësojnë komunikim të vazhdueshëm përmes radiolidhjeve me qendrën e tyre të kontrollit dhe me njëri-tjetrin, kur janë të caktuar në të njëjtën detyrë;</p> <p>6.2. Qendra e Kontrollit të ketë sistemin e GPS-së për përcjelljen e lëvizjes së automjeteve që përdoren nga TPG;</p> <p>6.3. rojet e TPG-së, të jenë të pajisur me pajisje të sigurimit dhe me armë zjarri në pajtim me këtë ligj dhe me ligjin përkatës për armë.</p>	<p>4.2. close Protection Operators are equipped with security equipment and firearms in accordance with this Law and the Law on Weapons.</p> <p>5. The Licensee for Cash in Transit services shall guard cash and other valuables during loading, transport and handover by means of vehicles certified by the Competent Body.</p> <p>6. In order to carry out CIT Services, the Licensees for Private Security Services shall make sure that:</p> <p>6.1 CIT Guards are equipped with means that enable continuous communication through radio links with their Control Centre, and with each other when performing the same duty;</p> <p>6.2. Control Centre is equipped with a GPS system, in order to monitor the movement of the vehicles used for CIT;</p> <p>6.3. CIT Guards are equipped with security equipment and firearms in accordance with this Law and Law on Weapons.</p>	<p>4.2. operateri bliske zaštite, budu opremljeni opremom obezbeđenja i vatrenim oružjem u skladu sa ovim zakonom i odgovarajućim zakonom o oružju.</p> <p>5. Posedioc dozvole za usluge transporta gotovine vrši čuvanje gotovine i druge dragocene stvari tokom prijema, transporta i dostavljanja sa sertifikovanim vozilima od nadležnog organa.</p> <p>6. Posedioc dozvole za usluge privatnog obezbeđenja, za obavljanje usluge TG-a, mora obezbediti da:</p> <p>6.1. Čuvari TG-a, su opremljeni sredstvima koja im omogućavaju kontinuiranu komunikaciju kroz radio veza sa svojim kontrolnim centrom i jedni sa drugima, kada su određeni na istu dužnost;</p> <p>6.2. Kontrolni centar da ima GPS sistem za praćenje kretanja vozila koja se koriste od TG;</p> <p>6.3. Čuvari TG-a, da budu opremljeni opremama obezbeđenja i vatrenim oružjem u skladu sa ovim zakonom i odgovarajućim zakonom o oružju.</p>
---	---	---

<p>7. Poseduesi i lejes për shërbimet e sigurimit për infrastrukturë kritike ofron shërbimin e sigurimit për hapësirën e siguruar, asetet me rëndësi të veçantë, objektin dhe pronën në hapësirën e siguruar të objekteve të përcaktuara, sipas legjislacionit përkatës për infrastrukturë kritike.</p>	<p>7. Licensee for Critical Infrastructure Security Services shall provide Security Services for the secured area, special importance assets, facility and property in the secured area of the facilities defined by the relevant legislation on critical infrastructure.</p>	<p>7. Posedioc dozvole za usluge obezbeđenja za kritičnu infrastrukturu pruža uslugu obezbeđenja za obezbeđeni prostor, imovine od posebnog značaja, objekta i imovine i lica u obezbeđenom prostoru objekata utvrđenih prema odgovarajućem zakonodavstvu za kritičnu infrastrukturu.</p>
<p>8. Poseduesi i lejes që ofron shërbimin e vëzhgimit elektronik të pronës, duhet të sigurojë se vëzhgimi elektronik është i kufizuar në:</p> <p>8.1. mbikëqyrjen e lëvizjes në dhe/ose përreth hapësirës së siguruar;</p> <p>8.2. identifikimin e prezencës së personave të paautorizuar në dhe/ose përreth hapësirës së siguruar;</p> <p>8.3. të vërejturit e pranisë së zjarrit në dhe/ose përreth hapësirës së siguruar.</p>	<p>8. Licensee providing Electronic Property Surveillance Services shall make sure that the electronic surveillance is limited to:</p> <p>8.1. supervision of movement in and/or around a secured area;</p> <p>8.2. identification of the presence of unauthorised persons in and/or around a secured area;</p> <p>8.3. detecting the presence of fire in and/or around a secured area.</p>	<p>8. Posedioc dozvole koji pruža uslugu elektronskog nadzora imovine, mora obezbediti da je elektronski nadzor ograničen na:</p> <p>8.1. nadzor kretanja u i/ili oko obezbeđenog prostora;</p> <p>8.2. identifikaciju prisustva neovlašćenih lica u i/ili oko obezbeđenog prostora;</p> <p>8.3. uočavanje prisustva vatre u i/ili oko obezbeđenog prostora.</p>
<p>9. Shenjat e dukshme dhe të dallueshme të njoftimit, të cilat informojnë publikun për prezencën e sistemeve elektronike, duhet të vendosen në dhe/ose përreth hapësirës së siguruar.</p>	<p>9. Visible and distinctive notification signs informing the public of the presence of such electronic systems shall be placed in and/or around a secured area.</p>	<p>9. Znakovi vidljivi i izraziti obaveštenja, koji informišu javnost o prisustvu elektronskih sistema, moraju se postaviti u i/ili oko obezbeđenog prostora.</p>
<p>10. Poseduesi i lejes për shërbimet e vëzhgimit elektronik të pronës duhet të ketë në gatishmëri të përhershme së paku dy (2) punëtorë të sigurimit themelor (patrullë), të cilët në rast të</p>	<p>10. Licensee for Electronic Property Surveillance Services shall have, in permanent readiness, at least two (2) Basic Security Workers (patrol) who shall, in case of an alarm</p>	<p>10. Posedioc dozvole za usluge elektronskog nadzora imovine, mora imati u stalnu pripravnost najmanje dva (2) radnika osnovnog obezbeđenja (patrole) koji u slučaju puštanje</p>



<p>lëshimit të alarmit ose me kërkesë të Qendrës së Kontrollit, vlerësojnë situatën, ndërmarrin masat e nevojshme në hapësirën e siguruar dhe raportojnë tek Qendra e Kontrollit.</p> <p>11. Poseduesi i lejes për shërbimet e sigurimit të ngjarjeve publike bën kontrollimin e hyrjes dhe daljes së pjesëmarrësve në ngjarje, siguron mbarëvajtjen, rendin dhe qetësinë në hapësirën e caktuar të ngjarjes publike.</p> <p>12. Poseduesit të lejes për shërbimet private të sigurisë dhe punëtorëve të sigurimit i ndalohet përdorimi i mjeteve të përgjimit të çfarëdo lloji.</p> <p>13. Poseduesi i lejes për ofrimin e shërbimeve private të sigurisë, ose klienti, nuk mund të urdhërojë punëtorin e sigurimit të përdorë forcën, apo pajisjet dhe mjetet e tjera shtrënguese që janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.</p> <p>14. Personat juridikë që ushtrojnë aktivitete në ambiente të jetës së natës dhe angazhojnë punëtorë të sigurimit dhe të cilat veprojnë pas orës 23:00 deri në orën 06:00 të mëngjesit, janë të obliguar të vendosin sisteme të vëzhgimit me kamera në hyrje/dalje dhe në hapësirën e siguruar, si dhe të kenë harduer për ruajtjen e incizimeve. Personat juridikë që nuk kontraktojnë posedues të lejes për shërbimet e</p>	<p>being tripped, or at the request of Control Centre, assess the situation and undertake the necessary measures in the secure area and report to the Control Centre.</p> <p>11. Licensee for Security Services of Public Gatherings shall control the entry and exit of participants at a gathering and ensure the smooth running, order and tranquillity at the designated area of the public gathering.</p> <p>12. Licensees for Private Security Services and Security Workers shall be prohibited from using Listening Devices of any kind.</p> <p>13. Licensee for providing Private Security Services or the client may not order the Security Worker to use force or perform duties, or use other restraining equipment and devices which are in violation to the provisions of this Law.</p> <p>14. Legal entities conducting activities in nightlife environments and employing Security Workers and which operate from 23:00 to 06:00 in the morning shall be obliged to install camera surveillance systems at entrances/exits and in the secured area, as well as have hardware for recording the footage. Legal persons that do not contract licensees for electronic property surveillance services, according to this law,</p>	<p>alarma ili na zahtev Kontrolnog centra procenjaju situaciju, preduzimaju potrebne mere u obezbeđenom prostoru i izveštavaju Kontrolni centar.</p> <p>11. Posedioc dozvole za usluge obezbeđenja javnih događaja, vrši kontrolu ulaza i izlaza učesnika na događaj, obezbeđuje nesmetan rad, red i mir u određenom prostoru javnog događaja.</p> <p>12. Posediocima dozvole za usluge privatnog obezbeđenja i radnicima obezbeđenja zabranjuje se korišćenje sredstava za prisluškivanje bilo kakve vrste.</p> <p>13. Posedioc dozvole za pružanje usluga privatnog obezbeđenja ili klijent, ne može da naloži radniku obezbeđenja upotrebi silu, oprema i drugih sredstava prinude koja su u suprotnosti sa odredbama ovog zakona.</p> <p>14. Pravna lica koja vrše aktivnosti u prostorijama noćnog života i angažuju radnike obezbeđenja, i koja deluju nakon 23:00 časova do 06:00 ujutru, dužna su da postave sisteme nadzora kamerama na ulazu/izlazu i u obezbeđenom prostoru, kao i da imaju hardver za čuvanje snimaka. Pravna lica koja nemaju ugovore sa nosiocima dozvola za usluge elektronskog nadzora imovine, prema ovom</p>
---	--	--

<p>vëzhgimit elektronik të pronës, sipas këtij ligji, incizimet me video duhet ti ruajnë së paku 3 muaj nga data e regjistrimit.</p> <p>15. Personat juridikë sipas paragrafit 14 të këtij neni, në rastet kur punëtorët e sigurimit përfshihen në veprat penale, duhet të përcjellin incizimet e regjistruara tek organi kompetent, sipas kërkesës.</p> <p>16. Ministri me akt nënligjor, përcakton autorizimet dhe detyrat e poseduesit të lejes për ofrimin e shërbimeve private të sigurisë në pajtim me këtë ligj.</p>	<p>shall keep video recordings for at least 3 months from the recording date.</p> <p>15. Legal entities under paragraph 14 of this Article, in cases where security workers are involved in criminal offenses, must forward the recorded recordings to the competent body, upon request.</p> <p>16. The Minister shall, by a bylaw, determine the authorisations and duties of Licensees for providing Private Security Services in accordance with this Law.</p>	<p>zakonu, dužna su da čuvaju video snimke najmanje 3 meseca od dana registracije.</p> <p>15. Pravna lica iz stava 14. ovog člana, u slučajevima kada su radnici obezbeđenja uključeni u krivična dela, dužna su da snimljene snimke, na zahtev, proslede nadležnom organu.</p> <p>16. Ministar podzakonskim aktom utvrđuje ovlašćenja i dužnosti nosioca dozvole za pružanje usluga privatnog obezbeđenja u skladu sa ovim zakonom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 26</b> <b>Autorizimet dhe detyrat e punëtorëve të sigurimit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 26</b> <b>Authorisations and duties of Security Workers</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 26</b> <b>Ovlašćenja i dužnosti radnika obezbeđenja</b></p>
<p>1. Punëtorët e sigurimit kanë të drejtë të ndërmarrin këto veprime:</p> <p>1.1. të tërheqin vërejtje ndaj personave të cilët pa autorizim përkatës afrohen në hapësirën e siguruar, objektin ose vendin e siguruar;</p> <p>1.2. të kërkojnë nga personi i cili rrezikon sigurinë e personave, apo pasurisë, ose vepron në kundërshtim me rregullat e hapësirës së siguruar që menjëherë të ndalojë veprimet;</p>	<p>1. Security Workers may undertake the following actions:</p> <p>1.1. warn subjects that approach a secured area or building, without proper authorisation;</p> <p>1.2. request that subject endangering the security of people and/or property or acting in violation to the rules of the secured area to cease their actions immediately;</p>	<p>1. Radnici obezbeđenja imaju pravo da preduzmu ove radnje:</p> <p>1.1. skreću pažnju na lica koja se bez odgovarajućeg ovlašćenja približavaju u obezbeđenom prostoru, objektu ili obezbeđenom mestu;</p> <p>1.2. zatražiti od lica koje ugrožava bezbednost lica ili imovine ili postupa u suprotnosti pravilima obezbeđenog prostora da odmah obustavi radnje;</p>

<p>1.3. të identifikojnë personat dhe automjetet gjatë hyrjes dhe daljes nga hapësira e siguruar, nëse është e domosdoshme për njerëzit ose pronën.</p> <p>2. Me pëlqimin e personit, punëtori i sigurimit mund të kontrollojë gjësendet dhe automjetet gjatë hyrjes dhe daljes në hapësirën e siguruar. Nëse personi refuzon t'i kontrollohen gjësendet dhe automjeti, punëtori i sigurimit mund t'i refuzojë hyrjen ose daljen nga hapësira e siguruar.</p> <p>3. Me pëlqimin e personit, punëtori i sigurimit mund të kryejë kontrollimin me prekje:</p> <p>3.1. kontrollimet me prekje duhet të kryhen nga punëtori i sigurimit i gjinisë së njëjtë;</p> <p>3.2. nëse personi refuzon pëlqimin për kontrollimin me prekje gjatë tentimit për të hyrë në hapësirën e siguruar, punëtori i sigurimit mund të refuzojë hyrjen e personit;</p> <p>3.3. nëse personi refuzon kontrollimin me prekje gjatë tentimit për të dalë nga hapësira e siguruar, punëtori i sigurimit ndalon personin dhe menjëherë njofton Policinë e Kosovës.</p>	<p>1.3. identify subjects and vehicles during entry to and exit from a secured area, if it is necessary for the security of people and/or property.</p> <p>2. Upon a subject's consent, a Security Worker may check the possessions and vehicles upon entry to and exit from a secured area. If the person refuses to have his/her belongings and vehicle checked, the security worker may refuse him entry to or exit from the secured area.</p> <p>3. Upon a subject's consent, a Security Worker may conduct a Pat-down search:</p> <p>3.1. Pat-down searches shall be performed by a Security Worker of the same gender;</p> <p>3.2. If a person refuses to the Pat-down search while attempting to enter a secured area, the Security Worker may deny the subject's entry;</p> <p>3.3. If a person refuses to consent for a Pat-down search while attempting to exit a secure area, the Security Worker shall stop the person and inform the Kosovo Police immediately.</p>	<p>1.3. da identifikuju lica i vozila tokom ulaska i izlaska iz obezbeđenog prostora ako je neophodno za ljude ili imovinu.</p> <p>2. Uz saglasnost lica, radnik obezbeđenja može kontrolisati stvari i vozila tokom ulaska i izlaska u obezbeđeni prostor. Ako lice odbije da mu se kontrolišu stvari i vozilo, radnik obezbeđenja može mu odbiti ulazak ili izlazak iz obezbeđenog prostora.</p> <p>3. Uz saglasnost lica, radnik obezbeđenja može obaviti kontrolu dodirom:</p> <p>3.1. kontrolisanja dodirom moraju se obaviti od radnika obezbeđenja istog pola;</p> <p>3.2. ako lice odbije saglasnost za kontrolu dodirom tokom pokušaja da uđe u obezbeđeni prostor, radnik obezbeđenja može odbiti ulazak lica;</p> <p>3.3. ako lice odbije kontrolu dodirom tokom pokušaja da izađe iz obezbeđeni prostor, radnik obezbeđenja zaustavlja lice i odmah obaveštava Policiju Kosova.</p>
---	--	---

<p>4. Punëtori i sigurimit mund të ndalojë personin vetëm nëse dyshon se personi ka kryer, ose është duke kryer, ose do të kryejë një vepër penale.</p>	<p>4. A Security Worker may only stop a person only if they suspect the person has committed is in the process of committing, or is about to commit a criminal offence.</p>	<p>4. Radnik obezbeđenja može da zaustavi lice samo ako sumnja da je lice počinilo, ili čini ili će počiniti krivično delo.</p>
<p>5. Nëse punëtori i sigurimit e ndalon personin apo automjetin duke dalë nga hapësira e siguruar dhe identifikon ndonjë keqpërdorim, punëtori i sigurimit duhet menjëherë të njoftojë Policinë e Kosovës.</p>	<p>5. If a Security Worker prohibits a person or vehicle exit a secured area and identifies any misuse, the Security Worker must immediately notify the Kosovo Police.</p>	<p>5. Ako radnik obezbeđenja zaustavi lice ili vozilo izlazeći iz obezbeđeni prostor i identifikuje neku zloupotrebu, radnik obezbeđenja mora odmah da obavesti Policiju Kosova.</p>
<p>6. Punëtori i sigurimit ka të drejtë t'i sekuestrojë përkohësisht sendet e kundërligjshme në hapësirën e siguruar dhe duhet ta njoftojë për këtë Policinë e Kosovës, si dhe menaxherin e sigurimit.</p>	<p>6. The Security Worker shall be entitled to temporarily seize illegal items in the secured area and shall immediately inform on this the Kosovo Police and the Security Manager.</p>	<p>6. Radnik obezbeđenja ima pravo da privremeno zapleni protivzakonite stvari u obezbeđenom prostoru i mora da obavesti Policiju Kosova kao i menadžera obezbeđenja.</p>
<p>7. Kufizimi i përkohshëm i lëvizjes së personit apo automjetit, lejohet vetëm deri në arritjen e policisë por jo më shumë se dy (2) orë nga momenti i ndalimit.</p>	<p>7. Limitation of movement of a person or vehicle shall be allowed only until the arrival of the police, but not more than (2) hours from the moment of detention.</p>	<p>7. Privremeno ograničavanje kretanja lica ili vozila, dozvoljava se samo do stizanja policije, ali ne duže od dva (2) sata od trenutka zaustavljanja.</p>
<p>8. Punëtorët e sigurimit mund ta përdorin forcën vetëm në pajtim me këtë ligj.</p>	<p>8. Security Workers may only use force in accordance with this Law.</p>	<p>8. Radnici obezbeđenja mogu koristiti silu samo u skladu sa ovim zakonom.</p>
<p>9. Punëtorët e sigurimit mund të përdorin vetëm pajisjet e sigurimit në pajtim me këtë ligj.</p>	<p>9. Security Workers may only use Security Equipment in accordance with this Law.</p>	<p>9. Radnici obezbeđenja mogu koristiti samo opreme obezbeđenja u skladu sa ovim zakonom.</p>
<p>10. Zyrtarët e zbatimit të ligjit gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, përjashtohen nga kontrollimi që e bëjnë punëtorët e sigurimit.</p>	<p>10. During the performance of their official duty, law enforcement officers shall be excluded from controls by Security Workers.</p>	<p>10. Službenici za sprovođenje zakona, tokom obavljanja službene dužnosti, isključuju se od kontrole koju vrše radnici obezbeđenja.</p>

<p>11. Në raste urgjente, shërbimet e urgjencës përjashtohen nga kontrollet e punëtorëve të sigurimit.</p> <p>12. Punëtorët e sigurimit duhet të identifikohen para policisë në bazë të kërkesës.</p> <p>13. Askush, në kontratën e punës të së cilit përshkruhen detyra e qëllime të ndryshme nga ato të shërbimeve private të sigurisë, nuk mund të veprojë si punëtor i sigurimit.</p> <p>14. Ministri me akt nënligjor përcakton autorizimet dhe detyrat e punëtorëve të sigurimit.</p>	<p>11. In case of emergency, emergency services shall be excluded from Security Workers' controls.</p> <p>12. Security Workers shall identify themselves to the Police upon request.</p> <p>13. No one, whose employment contract describes duties and purposes other than those of private security services, may act as a security worker.</p> <p>14. The Minister shall issue a sub-legal act determining authorisations and duties of Security Workers.</p>	<p>11. U hitnim slučajevima, usluge hitne pomoći isključuju se od kontrole radnika obezbeđenja;</p> <p>12. Radnici obezbeđenja mora da se identifikuju ispred policije na osnovu zahteva.</p> <p>13. Niko u čijem su ugovoru o radu opisani zadaci i ciljevi različiti od poslova privatnih službi obezbeđenja ne može delovati kao radnik obezbeđenja.</p> <p>14. Ministar podzakonskim aktom utvrđuje ovlašćenja i dužnosti radnika obezbeđenja.</p>
<p><b>Neni 27</b> <b>Përdorimi i forcës nga punëtori i sigurimit</b></p>	<p><b>Article 27</b> <b>Use of force by Security Worker</b></p>	<p><b>Član 27</b> <b>Upotreba sile od radnika obezbeđenja</b></p>
<p>1. Punëtori i sigurimit mund të përdorë forcën proporcionale kundër sulmit të drejtpërdrejtë të atëçastshëm dhe real që përbën kërcënim të pashmangshëm ndaj jetës dhe/apo integritetit trupor të tij apo ndonjë personi tjetër.</p> <p>2. Gjatë përdorimit të forcës proporcionale, askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor, ose poshtëruës.</p>	<p>1. A Security Worker may exercise the use of force against the immediate and real direct attack that poses an imminent threat to the life, bodily integrity of a person.</p> <p>2. When using the proportional force, no one shall be subjected to torture, cruel, inhuman or degrading treatment.</p>	<p>1. Radnik obezbeđenja može upotrebiti proporcionalnu silu protiv direktnog, momentalnog i realnog napada koji predstavlja neizbežnu pretnju na život i/ili telesni integritet nekog lica.</p> <p>2. Tokom upotrebe proporcijalne sile, niko ne može podleći torturi, neljudskom tretiranju ili kažnjavanju ili ponižavajući.</p>

<p>3. Përdorimi i forcës, si term i përdorur në këtë ligj, përfshin përdorimin e forcës fizike dhe pajisjeve të sigurisë.</p> <p>4. Në rastin e përdorimit të forcës, punëtori i sigurimit, menaxheri i sigurimit ose poseduesi i lejes është i detyruar të njoftojë menjëherë Policinë e Kosovës.</p> <p>5. Punëtori i sigurimit që i shkakton lëndime personit duhet të sigurohet se pala e lënduar do të marrë ndihmën mjekësore menjëherë pas marrjes së situatës nën kontroll.</p> <p>6. Përveç përcaktimeve në paragrafi 4 të këtij neni, poseduesi i lejes, përmes personit përgjegjës, duhet që brenda dyzetetë (48) orësh të raportojë me shkrim te organi kompetent për çfarëdo incidenti, kufizim të lëvizjes, lëndim të personit ose vepër penale.</p> <p>7. Gjatë përdorimit të forcës proporcionale punëtori i sigurimit duhet t'i ndjekë hapat në vijim:</p> <p>7.1. hapi i parë – prania fizike e punëtorit të sigurimit në vendngjarje;</p> <p>7.2. hapi i dytë – tërheqja e vërejtjes ndaj personit;</p>	<p>3. The use of force, as a term used in this Law, shall include the use of physical force and security equipment.</p> <p>4. In the case of the use of force, the Security Worker, Security Manager or the Licensee shall be obliged to immediately inform the Kosovo Police.</p> <p>5. A Security Worker who injures a person must ensure that the injured party receives medical assistance immediately after the situation is under control.</p> <p>6. In addition to what is stipulated in paragraph 4 of this Article, the licensee shall, through the responsible person, report in writing to the competent authority within forty-eight (48) hours of any incident, restriction of movement, injury to a person, or criminal offences.</p> <p>7. During the use of proportional force, the security worker must follow the following steps:</p> <p>7.1. step one - the physical presence of the Security Worker at the scene;</p> <p>7.2. step two - commanding a subject using warnings;</p>	<p>3. Upotreba sile, kao termin korišćen u ovom zakonu, uključuje upotrebu fizičke sile i opremu obezbeđenja.</p> <p>4. U slučaju upotrebe sile, radnik obezbeđenja, menadžer obezbeđenja ili posedioc dozvole obavezan je da odmah obavesti Policiju Kosova.</p> <p>5. Radnik obezbeđenja koji prouzrokuje povrede licu, mora se obezbediti da će oštećena strana dobiti medicinsku pomoć odmah nakon uzimanja situacije pod kontrolu.</p> <p>6. Osim što je utvrđeno u stavu 4 ovog člana, posedioc dozvole, kroz odgovornog lica, mora u roku od četrdeset osam (48) sati pismeno izvestiti kod nadležnog organa o svakom incidentu, ograničenju kretanja, povredu lica ili krivičnim delima.</p> <p>7. Tokom upotrebe proporcionalne sile, radnik obezbeđenja mora da sledi sledeće korake;</p> <p>7.1. prvi korak - fizičko prisustvo radnika obezbeđenja na mestu događaja;</p> <p>7.2. drugi korak - obraćanje pažnje (upozorenja) prema licu;</p>
--	--	---

<p>7.3. hapi i tretë – vënia nën kontroll e personit pa përdorimin e pajisjeve;</p> <p>7.4. hapi i katërt – përdorimi i sprejtit lotsjellës ose shkopit të sigurisë vetëm në pjesët muskulore të duarve dhe këmbëve të personit;</p> <p>7.5. hapi i pestë – përdorimi i forcës që mund të shkaktojë lëndim të rëndë të personit.</p> <p>8. Përdorimi i forcës duhet të ndërpritet në momentin kur punëtori i sigurimit e ka situatën nën kontroll.</p> <p>9. Ministri, me akt nënligjor përcakton mënyrën, rregullat dhe procedurën për zbatim të këtij neni.</p>	<p>7.3. step three - using open hands to control a subject;</p> <p>7.4. step four - using tear spray or security baton is only allowed on the muscular parts of the arms and legs of a subject;</p> <p>7.5. step five - using force which may cause permanent injury or death to a subject.</p> <p>8. The use of force must be stopped at the moment the Security Worker has the situation under control.</p> <p>9. The Minister shall, by a bylaw, determine the manner, rules and procedure for the implementation of this Article.</p>	<p>7.3. treći korak - stavljanje lica pod kontrolu bez upotrebe oprema;</p> <p>7.4. četvrti korak - korišćenje suzavca ili palice bezbednosti samo na mišićnim delovima ruku i nogu lica;</p> <p>7.5. peti korak - upotreba sile koja može uzrokovati teške povrede licu.</p> <p>8. Upotreba sile treba se prekinuti u trenutku kada radnik obezbeđenja ima situaciju pod kontrolom.</p> <p>9. Ministar, podzakonskim aktom utvrđuje način, pravila i postupak za sprovođenje ovog člana.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 28</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Bartja dhe përdorimi i armëve të zjarrit</b></p> <p>1. Operatorët e mbrojtjes së afërt, rojet e TPG-së dhe punëtorët e sigurimit për infrastrukturë kritike, të autorizuar me kartelë të identifikimit, mund të armatosen vetëm në pajtim me këtë ligj dhe me ligjin përkatës për armë.</p> <p>2. Operatorët e mbrojtjes së afërt, rojet e TPG-së dhe punëtorët e sigurimit për infrastrukturë</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 28</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Carrying and using firearms</b></p> <p>1. Close Protection Operatives, CIT Guards and Security Workers for Critical Infrastructure, authorised with Official Identification Cards shall be armed only in accordance with this Law and the relevant Law on Weapons.</p> <p>2. Security Workers, Close Protection Operatives, CIT Guards, and Security Workers for Critical Infrastructure, authorised people</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 28</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Nošenje i upotreba vatrenih oružja</b></p> <p>1. Operateri bliske zaštite, čuvari TG-a i radnici obezbeđenja za kritičnu infrastrukturu, ovlašćeni identifikacionom kartom, mogu na se naoružaju samo u skladu sa ovim zakonom i sa odgovarajućim zakonom o oružju.</p> <p>2. Operateri bliske zaštite, čuvari TG-a, i radnici obezbeđenja za kritičnu infrastrukturu</p>

<p>kritike të autorizuar me kartelë të identifikimit, duhet të armatosen si vijon:</p> <p>2.1. armët e zjarrit të autorizuar për operatorët e mbrojtjes së afërt janë kategori B1, siç është përcaktuar në ligjin përkatës për armë, me velenxën mekanike të sigurisë dhe municion të kalibrit 9x19 mm, me përjashtim të revolverëve.</p> <p>2.2. armët e autorizuar për rojet e TPG-së janë kategori B1, siç është përcaktuar në ligjin përkatës për armë me velenxën mekanike të sigurisë dhe municion të kalibrit 9x19mm, me përjashtim të revolverëve dhe minimum një armë B1 gjysmë automatike, jo më të gjatë se 60cm me kalibër 9x19 mm për çdo automjet transportues të TPG-së.</p> <p>2.3. armët e autorizuar për punëtorët e sigurimit për infrastrukturë kritike janë kategori B1, siç është përcaktuar në ligjin përkatës për armë, me velenxën mekanike të sigurisë dhe municion të kalibrit 9x19 mm, me përjashtim të revolverëve.</p> <p>3. Operatorët e mbrojtjes së afërt, rojet e TPG-së, dhe punëtorët e sigurimit për infrastrukturë kritike duhet të armatosen vetëm me armë të autorizuar dhe t'i bartin vetëm kur janë në</p>	<p>with Official Identification Card shall be armed as follows:</p> <p>2.1. authorised firearms for Close Protection Operatives are Category B1 as defined in the Law on Weapons with a mechanical safety pall, and ammunition of calibre 9x19 mm, excluding revolvers;</p> <p>2.2. authorised firearms for CIT Guards are Category B1 as defined in the Law on Weapons with a mechanical safety pall, conventional barrels and ammunition of calibre 9 x 19 mm with full metal jacket projectile, excluding revolvers, and minimum of one B1 semi-automatic weapon, no longer than 60 cm in 9x19mm calibre for each CIT transport vehicle.</p> <p>2.3. authorised firearms for Security Workers for Critical Infrastructure are Category B1 as defined in the Law on Weapons with a mechanical safety pall, conventional barrels and ammunition of calibre 9 x 19 mm with full metal jacket projectile, excluding revolvers.</p> <p>3. Close Protection Operatives, CIT Guards and Security Workers for Critical Infrastructure shall be armed only with authorised weapons and carry them only when on duty. After the</p>	<p>ovlašćeni identifikacionom kartom moraju se naoružati kao u nastavku:</p> <p>2.1. vatrena oružja odobrena za operatere bliske zaštite su kategorija B1, kako je utvrđeno u odgovarajućem zakonu o oružju sa mehaničkim ventilom bezbednosti, i municijom kalibra 9x19 mm, sa izuzetkom revolvera.</p> <p>2.2. dozvoljena oružja za čuvare TG-a su kategorija B1, kako je utvrđeno u odgovarajućem zakonu o oružju sa mehaničkim ventilom bezbednosti, i municijom kalibra 9x19 mm, sa izuzetkom revolvera i minimum jednog poluautomatskog oružja B1, ne dužeg od 60cm kalibra 9x19 mm za svako transportno vozilo TG-a.</p> <p>2.3. oružja ovlašćena za radnike obezbeđenja za kritičnu infrastrukturu su kategorija B1, kako je utvrđeno u odgovarajućem zakonu o oružju, sa mehaničkim ventilom bezbednosti, i municijom kalibra 9x19 mm, sa izuzetkom revolvera.</p> <p>3. Operateri bliske zaštite, čuvari TG-a i radnici obezbeđenja za kritičnu infrastrukturu, moraju se naoružati samo ovlašćenim oružjem i nositi ih samo kada su na dužnosti. Nakon završetka</p>
--	--	---



<p>detyrë. Pas përfundimit të orarit të punës armët e zjarrit duhet t'i dorëzojnë në vendin e ruajtjes sipas ligjit përkatës për armë.</p> <p>4. Përjashtimisht nga paragrafi 3 i këtij neni, punëtorët e sigurimit për infrastrukturë kritike mund t'ia dorëzojnë armën punëtorit të sigurimit i cili e pranon detyrën tek vendi i tyre i punës.</p> <p>5. Operatorët e mbrojtjes së afërt, rojet e TPG-së dhe punëtorët e sigurimit për infrastrukturë kritike, mund të përdorin armët e tyre të autorizuara vetëm si zgjidhje e fundit, kur mjetet tjera janë të pamjaftueshme për të mbrojtur veten, personin e siguruar, transportin e parave të gatshme dhe infrastrukturën kritike nga sulmi i pashmangshëm për jetë.</p> <p>6. Për përdorimin e armës së autorizuar të zjarrit, duhet të ndiqen hapat si në vijim:</p> <p>6.1. hapi i parë – nxjerrja e armës së zjarrit;</p> <p>6.2. hapi i dytë – tërheqja e vërejtjes së personit, se punëtori i sigurimit do të shtjerë dhe futja e plumbit në tytë në armën e zjarrit;</p> <p>6.3. hapi i tretë – drejtimi i armës së zjarrit kundrejt personit;</p>	<p>end of working hours, the firearms shall be handed over to the weapon storage location according to Law on Weapons.</p> <p>4. Except for paragraph 3 of this Article, Security Workers for Critical Infrastructure may hand over their weapons to the Security Worker taking over the duty at their workplace.</p> <p>5. Close Protection Operatives, CIT Guards and Security Workers for Critical Infrastructure may use their authorised weapons only as a measure of last resort when other means are insufficient to defend themselves, the secured person, Cash in Transit and critical infrastructure from an imminent attack on life.</p> <p>6. When using an authorised firearm, there are certain steps which shall be followed:</p> <p>6.1. step one - drawing the firearm;</p> <p>6.2. step two - warning on the subject that the Security Worker will fire and chambering a bullet;</p> <p>6.3. step three - pointing the firearm at the subject;</p>	<p>radnog vremena, vatrena oružja moraju predati na mesto čuvanja prema odgovarajućem zakonu o oružju.</p> <p>4. Izuzev iz stava 3. ovog člana, radnici obezbeđenja za kritičnu infrastrukturu mogu predati oružje radniku obezbeđenja koji prihvata dužnost na njihovom radnom mestu.</p> <p>5. Operateri bliske zaštite, čuvari TG-a i radnici obezbeđenja za kritičnu infrastrukturu mogu koristiti svoja ovlašćena oružja samo kao poslednje rešenje kada druga sredstva su nedovoljna da zaštite sebe, obezbeđeno lice, transport gotovine i kritičnu infrastrukturu od neizbežnog napada na život.</p> <p>6. Za upotrebu ovlašćenog vatrenog oružja, moraju se slediti koraci kao u nastavku:</p> <p>6.1. prvi korak - vađenje vatrenog oružja;</p> <p>6.2. drugi korak - obraćanje pažnje (upozorenja) licu, da će radnik obezbeđenja pucati i ubacivanje metka u cev u vatreno oružje;</p> <p>6.3. treći korak - usmeravanje vatrenog oružja prema licu;</p>
---	--	--

<p>6.4. hapi i katërt – lirimi i velenxës së sigurisë;</p> <p>6.5. hapi i pestë – të shtënit me armë të zjarrit.</p> <p>7. Operatori i mbrojtjes së afërt, roja e TPG-së ose punëtorët e sigurimit për infrastrukturë kritike janë të obliguar që drejtpëdrejt, ose përmes Qendrës së Kontrollit, të njoftojnë Policinë e Kosovës, menjëherë pasi është shtënë me armën e zjarrit.</p> <p>8. Nëse hetimi i Policisë së Kosovës zbulon se e shtëna me armë zjarri nuk ishte në pajtim me këtë ligj, atëherë punëtorit të sigurimit menjëherë i hiqet kartela e identifikimit nga organi kompetent.</p> <p>9. Punëtorit të sigurimit i cili posedon armë të paautorizuar të zjarrit, sa është në detyrë, menjëherë i hiqet kartela e identifikimit. Nëse konstatohet përgjegjësia e poseduesit të lejes për shërbimet private të sigurisë, leja i hiqet edhe kompanisë private të sigurimit.</p> <p>10. Ministri me akt nënligjor përcakton kushtet dhe kriteret për pajisjen me armë, mënyrën dhe përdorimin e armës së zjarrit, si dhe ruajtjen e armës së zjarrit, trajtimin e armëve nga</p>	<p>6.4. step four - disengaging the safety pall;</p> <p>6.5. step five - discharging the firearm.</p> <p>7. Close Protection Operator, CIT Guard or Security Worker for Critical Infrastructure shall notify the Kosovo Police directly or through the Control Centre immediately after discharge of the firearm.</p> <p>8. Every discharge of a firearm by a Security Worker, whether intentional or unintentional, will be subject to an immediate investigation by the Kosovo Police and the findings of such an investigation will be detailed in a report.</p> <p>9. A Security Worker who holds an unauthorised firearm while on duty, his Official Identification Card shall be immediately revoked. If the licensee is found to be responsible for Private Security Services, the license of the Private Security Company may also be revoked.</p> <p>10. The Minister shall, by a bylaw, determine the conditions and requirements for weapons, the manner and use of firearms, as well as the storing of firearms, handling of weapons by</p>	<p>6.4. četvrti korak - oslobađanje ventila bezbednosti;</p> <p>6.5. peti korak - pucanje sa vatrenog oružja.</p> <p>7. Operater bliske zaštite, čuvar TG-a ili radnici obezbeđenja za kritičnu infrastrukturu, obavezni su da direktno ili preko Kontrolnog centra obaveste Policiju Kosova odmah nakon što je ispaljeno sa vatrenog oružja.</p> <p>8. Ako istraga Policije Kosova otkrije da pucnjava sa vatrenog oružja nije bila u skladu sa ovim zakonom, onda će se radniku obezbeđenja odmah oduzeti identifikaciona karta od nadležnog organa.</p> <p>9. Radniku obezbeđenja koji poseduje neovlašćeno vatreno oružje, dok je na dužnosti, odmah će se oduzeti identifikaciona karta. Ako se utvrdi odgovornost posedioca dozvole za privatne usluge obezbeđenja, dozvola se oduzima i privatnoj kompaniji obezbeđenja.</p> <p>10. Ministar podzakonskim aktom, utvrđuje uslove i kriterijume za oružje, način i upotrebuvatrenog oružja, kao i čuvanje vatrenog oružja, tretiranje oružja od radnika</p>
--	---	---

<p>punëtorët e sigurimit dhe kompania private e sigurimit, në pajtim me këtë ligj.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 29 Qentë e sigurimit</b></p> <p>1. Përdorimi i qenve të sigurimit lejohet për aktivitetet e shërbimeve private të sigurisë.</p> <p>2. Poseduesi i lejes duhet të ketë një policë sigurimi për përdorimin e qenve të sigurimit për dëmet që mund t'i shkaktojë palës së tretë.</p> <p>3. Ministri me akt nënligjor përcakton rregullat procedurat dhe kriteret për zbatimin e këtij neni.</p>	<p>Security Workers and Private Security Company in accordance with this Law.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 29 Security dogs</b></p> <p>1. Use of security dogs shall be permitted for the activity of Basic Security Services only.</p> <p>2. The licensee shall have an insurance policy for the use of security dogs for the damages it may cause to a third party.</p> <p>3. The Minister shall, by a bylaw, set the rules, procedures and criteria for the implementation of this Article.</p>	<p>obezbeđenja i privatne kompanije obezbeđenja u skladu sa ovim zakonom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 29 Psi obezbeđenja</b></p> <p>1. Korišćenje pasa obezbeđenja dozvoljava se za aktivnosti usluga privatnog obezbeđenja.</p> <p>2. Posedioc dozvole mora imati polisu osiguranja za korišćenje pasa obezbeđenja za štete koje može uzrokovati trećoj strani.</p> <p>3. Ministar podzakonskim aktom utvrđuje pravila, postupke i kriterijume za sprovođenje ovog člana.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 30 Pajisjet e sigurimit</b></p> <p>1. Punëtorët e sigurimit mund të përdorin vetëm pajisjet e sigurimit të lejuara me këtë ligj.</p> <p>2. Punëtorëve të sigurimit ju ofrohen nga poseduesi i lejes që i punëson pajisjet e domosdoshme për t'i përmbushur detyrat e tyre.</p> <p>3. Pajisja e sigurimit duhet të përdoret nga punëtorët e sigurimit vetëm për aktivitetet e sigurimit, për të cilat ata janë të autorizuar me kartelë të identifikimit.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 30 Security equipment</b></p> <p>1. Only Security Equipment approved by this Law may be used by Security Workers.</p> <p>2. Security Workers shall be provided with the necessary equipment to accomplish their duties by the Licensee which employs them.</p> <p>3. Security Equipment shall be used by Security Workers only in the activity of security for which they are authorised under the Identity Card.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 30 Opreme obezbeđenja</b></p> <p>1. Radnici obezbeđenja mogu koristiti samo opreme obezbeđenja dozvoljene ovim zakonom.</p> <p>2. Radnicima obezbeđenja biće pružene neophodne opreme od posedioca dozvole da bi ispunili svoje dužnosti.</p> <p>3. Oprema obezbeđenja mora se koristiti od radnike obezbeđenja samo za aktivnost obezbeđenja za koju su oni ovlašćeni sa identifikacionom kartom.</p>

<p>4. Pajisjet bazike të sigurimit që mund të përdoren nga të gjithë punëtorët e sigurimit janë si në vijim:</p> <p>4.1. shufra;</p> <p>4.2. prangat;</p> <p>4.3. sprej lotsjellës;</p> <p>4.4. pajisja e komunikimit apo radiolidhja;</p> <p>4.5. jeleku antiplumb;</p> <p>4.6. helmata;</p> <p>4.7. dylbitë;</p> <p>4.8. maska kundër gazit;</p> <p>4.9. detektori me rreze X;</p> <p>4.10. detektorët për zbulimin e metalit;</p> <p>4.11. detektorët që kalojnë përmes tyre;dhe</p> <p>4.12. bllokuesi i rrotave.</p>	<p>4. The following basic security equipment may be used by all Security Workers:</p> <p>4.1. batons;</p> <p>4.2. handcuffs;</p> <p>4.3. tear spray;</p> <p>4.4. communication equipment or walkie-talkies;</p> <p>4.5. bulletproof vests;</p> <p>4.6. helmets;</p> <p>4.7. binoculars;</p> <p>4.8. gas masks;</p> <p>4.9. X-ray detectors;</p> <p>4.10. metal detectors;</p> <p>4.11. walkthrough detectors; and</p> <p>4.12. wheel clamps.</p>	<p>4. Osnovne opreme obezbeđenja koje se mogu koristiti od svih radnika obezbeđenja su kao u nastavku:</p> <p>4.1. šipke;</p> <p>4.2. lisice;</p> <p>4.3. suzavac;</p> <p>4.4. komunikaciona oprema ili radio veza;</p> <p>4.5. pancirke;</p> <p>4.6. kacige;</p> <p>4.7. dvogledi;</p> <p>4.8. gas maske;</p> <p>4.9. detektor sa X-zrakom;</p> <p>4.10. detektori za otkrivanje metala;</p> <p>4.11. detektori kroz kojih se prolazi;i</p> <p>4.12. sigurnosna brave točkova.</p>
<p>5. Pajisjet e sigurimit që duhet t'i bartin punëtorët e sigurimit themelor gjatë gjithë kohës sa janë në detyrë, janë si në vijim:</p>	<p>5. The safety equipment that Basic Security Workers must carry, all the time while they are on duty, shall be as follows:</p>	<p>5. Opreme obezbeđenja koje radnici osnovnog obezbeđenja moraju nositi, tokom čitavog vremena dok su na dužnosti, su kao u nastavku:</p>

<p>5.1. shufra;</p> <p>5.2. prangat;</p> <p>5.3.pajisjet e komunikimit apo radiolidhje; dhe</p> <p>5.4. sprej lotsjellës.</p> <p>6. Pajisjet e sigurimit që duhet t'i bartin operatorët e mbrojtjes së afërt, gjatë gjithë kohës sa janë në detyrë, janë si në vijim:</p> <p>6.1. arma e zjarrit;</p> <p>6.2. shufra;</p> <p>6.3. prangat;</p> <p>6.4. sprej lotsjellës; dhe</p> <p>6.5. pajisja e komunikimit apo radiolidhja.</p> <p>7. Pajisjet e sigurimit të nevojshme për kryerjen e transportit të parave të gatshme nga rojet e TPG-së, gjatë gjithë kohës sa janë në detyrë, janë si në vijim:</p> <p>7.1. arma e zjarrit;</p> <p>7.2. shufra;</p>	<p>5.1. batons;</p> <p>5.2. handcuffs;</p> <p>5.3. communication equipment or walkie-talkies; and</p> <p>5.4. tear spray.</p> <p>6. The safety equipment that Close Protection Operatives must carry, all the time they are on duty, shall be as follows:</p> <p>6.1. firearms;</p> <p>6.2. batons;</p> <p>6.3. handcuffs;</p> <p>6.4. tear spray; and</p> <p>6.5. communication equipment or walkie-talkies;</p> <p>7. The security equipment required to carry out the Cash in Transit services by CIT guards, during all the time they are on duty, shall be as follows:</p> <p>7.1. firearms;</p> <p>7.2. batons;</p>	<p>5.1. šipke;</p> <p>5.2. lisice;</p> <p>5.3. komunikacione opreme ili radio veza; i</p> <p>5.4. suzavac.</p> <p>6. Opreme obezbeđenja koje moraju nositi operateri bliske zaštite, tokom čitavog vremena dok su na dužnosti, su kao u nastavku:</p> <p>6.1. vatreno oružje;</p> <p>6.2. šipke;</p> <p>6.3. lisice;</p> <p>6.4. suzavac; i</p> <p>6.5. komunikaciona oprema ili radio veza.</p> <p>7. Opreme obezbeđenja potrebne za obavljanje transporta gotovine od čuvara TG-a, tokom čitavog vremena dok su na dužnosti, su kao u nastavku:</p> <p>7.1. vatreno oružje;</p> <p>7.2. šipka;</p>
---	---	--

<p>7.3. prangat;</p> <p>7.4. sprej lotsjellës;</p> <p>7.5. jeleku antiplumb;</p> <p>7.6. pajisjet e komunikimit apo radiolidhja;</p> <p>7.7. maska kundër gazit;</p> <p>7.8. automjeti i blinduar dhe certifikuar nga organi kompetent.</p> <p>8. Pajisjet e sigurimit që duhet t'i bartin punëtorët e sigurimit për infrastrukturë kritike, gjatë gjithë kohës sa janë në detyrë, janë si në vijim:</p> <p>8.1. arma e zjarrit;</p> <p>8.2. shufra;</p> <p>8.3. prangat;</p> <p>8.4. sprej lotsjellës; dhe</p> <p>8.5. pajisjet e komunikimit apo radiolidhja.</p>	<p>7.3. handcuffs;</p> <p>7.4. tear spray;</p> <p>7.5. bulletproof vests;</p> <p>7.6. communication equipment or walkie-talkies;</p> <p>7.7. gas masks;</p> <p>7.8. armoured vehicle certified by the competent body.</p> <p>8. The safety equipment that Security Workers for Critical Infrastructure must carry, all the time while they are on duty, shall be as follows:</p> <p>8.1. firearms;</p> <p>8.2. batons;</p> <p>8.3. handcuffs;</p> <p>8.4. tear spray; and</p> <p>8.5. communication equipment or walkie-talkies;</p>	<p>7.3. lisice;</p> <p>7.4. suzavac;</p> <p>7.5. pancirke;</p> <p>7.6. komunikaciona oprema ili radio veza;</p> <p>7.7. gas maske;</p> <p>7.8. oklopno vozilo sertifikovano od nadležnog organa.</p> <p>8. Opreme obezbeđenja koje moraju nositi radnici obezbeđenja za kritičnu infrastrukturu, tokom čitavog vremena dok su na dužnosti, su kao u nastavku:</p> <p>8.1. vatreno oružje;</p> <p>8.2. šipka;</p> <p>8.3. lisice;</p> <p>8.4. suzavac; i</p> <p>8.5. komunikaciona oprema ili radio veza.</p>
---	--	--

<p>9. Operatorët e mbikëqyrjes elektronike mbikëqyrin pajisjet dhe sistemet si në vijim:</p> <p>9.1. alarmet kundër hyrjes së paautorizuar;</p> <p>9.2. sistemet e kontrollit për qasje elektronike;</p> <p>9.3. sistemin e kamerave CCTV;</p> <p>9.4. ruajtjen e imazheve filmike në pajisje për ruajtjen e të dhënave;</p> <p>9.5. pajisjet për vëzhgim optik;</p> <p>9.6. mjetet e përcjelljes përmes GPS të automjeteve dhe pajisjet e tjera, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>10. Ministri me akt nënligjor përcakton llojin, ruajtjen, përdorimin, evidentimin, si dhe kriteret e kërkuara për pajisjet e sigurisë.</p>	<p>9. Electronic Surveillance Operators shall monitor the following equipment and systems:</p> <p>9.1. intruder alarms;</p> <p>9.2. electronic access control systems;</p> <p>9.3. CCTV camera system;</p> <p>9.4. saving video images on data storage devices;</p> <p>9.5. optical surveillance devices;</p> <p>9.6. GPS vehicle tracking devices and other devices, in accordance with the current legislation.</p> <p>10. The Minister shall, by a bylaw, determine the type, storage, use, recording and the required criteria for security devices.</p>	<p>9. Operateri elektronskog nadzora nadgledaju opreme i sisteme kao u nastavku:</p> <p>9.1. alarmi protiv neovlašćenog ulaska;</p> <p>9.2. kontrolni sistemi za elektronski pristup;</p> <p>9.3. sistem CCTV kamera;</p> <p>9.4. čuvanje filmskih slika na uređaje za čuvanje podataka;</p> <p>9.5. opreme za optičko promatranje;</p> <p>9.6. sredstva za praćenje vozila preko GPS i druge opreme, prema zakonodavstvu na snazi.</p> <p>10. Ministar podzakonskim aktom utvrđuje vrstu, čuvanje, upotrebu, evidentiranje, kao i kriterijume zahtevane za opreme obezbeđenja.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 31</b> <b>Uniforma, shenjat dalluese dhe emblemat</b></p> <p>1. Punëtorët e sigurimit duhet të kenë të veshur uniformat e punës, të aprovuara nga organi kompetent, gjatë tërë kohës sa janë në detyrë.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 31</b> <b>Uniforms, badges and emblems</b></p> <p>1. Security Workers shall wear duty uniforms, approved by the Competent Body, at all times while on duty.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 31</b> <b>Uniforma, oznake i amblemi</b></p> <p>1. Radnici obezbeđenja mora da imaju obučene radne uniforme odobrene od nadležnog organa, tokom čitavog vremena dok su na dužnosti.</p>

<p>2. Poseduesi i lejes për shërbimet e mbrojtjes së afërt mund të autorizojë operatorët e mbrojtjes së afërt që të mos veshin uniformë.</p> <p>3. Poseduesi i lejes për ofrimin e shërbimeve private të sigurisë, është i obliguar që me shpenzimet e tij t'i pajisë me uniforma të punës punëtorët e sigurimit.</p> <p>4. Ministri me akt nënligjor përcakton llojin dhe përmbajtjen e emblemës dhe shenjave dalluese, sinjalet ndriçuese dhe kthimin e uniformës nga punëtori i sigurimit.</p>	<p>2. The Licensee for Close Protection Services may authorise Close Protection Operatives to dress in non-uniform clothing.</p> <p>3. The Licensees for Private Security Services shall be obliged to provide their Security Workers with uniforms at their own expense.</p> <p>4. The Minister shall, by bylaw, determine the type and content of the emblem and badges, signalling devices and return of the uniform by the Security Worker.</p>	<p>2. Posedioc dozvole za usluge bliske zaštite može ovlastiti operatere bliske zaštite da ne oblače uniformu.</p> <p>3. Posedioc dozvole za pružanje usluga privatnog obezbeđenja, obavezan je da na trošak opremi radnim uniformama svoje radnike obezbeđenja.</p> <p>4. Ministar podzakonskim aktom utvrđuje vrstu i sadržaj amblema i znakova razlikovanja, svetlosne signale i vraćanje uniforme od radnika obezbeđenja.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 32</b> <b>Trajnimi themelor profesional</b></p> <p>1. Personi i cili do të punojë si punëtor i sigurimit duhet të kryejë trajnimin themelor profesional dhe të certifikohet nga institucioni trajnues për ofrimin e trajnimeve në fushën private të sigurisë që posedon leje nga organi kompetent.</p> <p>2. Personi nga paragrafi 1 i këtij neni pajiset me certifikatë të lëshuar nga organi kompetent që dëshmon se ka marrë njohuri dhe ka kaluar provimin shtetëror për punëtor të sigurimit themelor.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 32</b> <b>Basic vocational training</b></p> <p>1. The person to be working as a Security Worker shall complete the basic vocational training and shall be certified by the training institution providing training in the field of Private Security, licensed by the Competent Body.</p> <p>2. The person referred to in paragraph 1 of this Article shall be provided with a certificate issued by the Competent Body, proving that he/she has acquired knowledge and passed the state exam for Basic Security Worker.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 32</b> <b>Osnovna stručna obuka</b></p> <p>1. Lice koje će raditi kao radnik obezbeđenja, mora da završi osnovnu stručnu obuku i da se sertifikuje od institucije za obuku za pružanje obuka u oblasti privatnog obezbeđenja koja poseduje dozvolu od nadležnog organa.</p> <p>2. Lice iz stava 1. ovog člana oprema se sertifikatom izdatim od nadležnog organa koji dokazuje da je steklo znanje i da je položilo državni ispit za radnika osnovnog obezbeđenja.</p>



<p>3. Të gjitha temat e programit të trajnimit themelor profesional duhet të aprovohen nga organi kompetent.</p> <p>4. Ministri me akt nënligjor, përcakton mënyrën e aplikimit, procedurat e trajnimit, provimit shtetëror, testimin, certifikimin të punëtorëve të sigurimit themelor nga organi kompetent, temat, aprovimin e plan-programeve për trajnim themelor profesional, si dhe mënyrën e ofrimit të trajnimit dhe certifikimit nga institucionet trajnuese.</p>	<p>3. All topics of basic vocational training and periodic training program shall be approved by the Competent Body.</p> <p>4. The Minister shall, by a bylaw, determine the manner of application, procedures of training, state exam, testing, certification of Basic Security Workers by the Competent Body, the topics, the approval of basic vocational training curricula, and the manner of providing training and certification by training institutions.</p>	<p>3. Sve teme programa osnovne stručne obuke, moraju se odobriti od nadležnog organa.</p> <p>4. Ministar podzakonskim aktom utvrđuje način apliciranja, postupke obuke, državnog ispita, testiranja, sertifikacije radnika osnovnog obezbeđenja od nadležnog organa, teme, odobravanje plan-programa za osnovnu stručnu obuku, kao i način pružanja obuke i sertifikacije od institucija za obuku.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Nen 33</b> <b>Trajnimi për punëtorë të specializuar të sigurimit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 33</b> <b>Training for Specialist Security Workers</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 33</b> <b>Obuka za specijalizovane radnike obezbeđenja</b></p>
<p>1. Punëtori i specializuar i sigurimit duhet të kryejë trajnimin e specializuar përkatës, të cilin e ofron institucioni trajnues që posedon leje nga organi kompetent.</p> <p>2. Personi që aplikon për trajnim të specializuar duhet të ketë të kryer provimin shtetëror për punëtor të sigurimit themelor.</p> <p>3. Personi nga paragrafi 1 i këtij neni pajiset me certifikatë, të lëshuar nga organi kompetent që dëshmon se ka marrë njohuri dhe ka kaluar provimin shtetëror përkatës për punëtor të specializuar të sigurimit.</p>	<p>1. The Specialist Security Worker shall complete the relevant specialised training provided by the training institution licensed by the Competent Body.</p> <p>2. The person applying for specialised training must have passed the state exam for Basic Security Worker.</p> <p>3. The person referred to in paragraph 1 of this Article shall be provided with a certificate issued by the Competent Body proving that he/she has acquired knowledge and has passed the relevant state exam for a Specialist Security Worker.</p>	<p>1. Specijalizovani radnik obezbeđenja mora završiti odgovarajuću specijalizovanu obuku koju pruža institucija za obuku koja poseduje dozvolu od nadležnog organa.</p> <p>2. Lice koje aplicira za specijaliziranu obuku, mora imati položen državni ispit za radnika osnovnog obezbeđenja.</p> <p>3. Lice iz stava 1. ovog člana oprema se sertifikatom, izdatim od nadležnog organa, koji dokazuje da je steklo znanje i da je položilo odgovarajući državni ispit za specijalizovanog radnika obezbeđenja.</p>

<p>4. Trajnimet e specializuara kryhen për:</p> <p>4.1. operator i mbrojtjes së afërt;</p> <p>4.2. roje e TPG-së;</p> <p>4.3. punëtor i sigurimit për infrastrukturë kritike;</p> <p>4.4. mbajtës i qenve;</p> <p>4.5. operator i Qendrës së Kontrollit;</p> <p>4.6. menaxher i sigurimit për shërbimet themelore të sigurimit;</p> <p>4.7. menaxher i sigurimit për shërbimet e mbrojtjes së afërt;</p> <p>4.8. menaxher i sigurimit për shërbimet e transportit të parave të gatshme dhe sendeve me vlerë;</p> <p>4.9. menaxher i sigurimit për shërbimet e mbikëqyrjes elektronike;</p> <p>4.10. menaxher i sigurimit për shërbimet e infrastrukturës kritike.</p> <p>5. Të gjitha institucionet që ofrojnë trajnime, duhet të posedojnë leje nga organi kompetent.</p>	<p>4. Specialised Training shall be completed by:</p> <p>4.1. close protection operatives;</p> <p>4.2. CIT Guards;</p> <p>4.3. security worker for critical infrastructure;</p> <p>4.4. dog-handlers;</p> <p>4.5. control centre operator;</p> <p>4.6. security manager for basic security services;</p> <p>4.7. security manager for close protection services;</p> <p>4.8. security manager for cash and valuables in transit services;</p> <p>4.9. security manager for electronic surveillance services;</p> <p>4.10. security manager for critical infrastructure services.</p> <p>5. All institutions providing training shall be licensed by the Competent Body.</p>	<p>4. Specijalizovane obuke se obavljaju za:</p> <p>4.1. operatera bliske zaštite;</p> <p>4.2. čuvari TG-a;</p> <p>4.3. radnik obezbeđenja za kritičnu infrastrukturu;</p> <p>4.4. držalac pasa;</p> <p>4.5. operater Kontrolnog centra;</p> <p>4.6. menadžer obezbeđenja za osnovne usluge obezbeđenja;</p> <p>4.7. menadžer obezbeđenja za usluge bliske zaštite;</p> <p>4.8. menadžer obezbeđenja za usluge transporta gotovine i dragocenih stvari;</p> <p>4.9. menadžer obezbeđenja za usluge elektronskog nadzora;</p> <p>4.10. menadžer obezbeđenja za usluge kritične infrastrukture.</p> <p>5. Sve institucije koje pružaju obuke moraju posedovati dozvolu od nadležnog organa.</p>
--	---	---

<p>6. Të gjitha temat e programit për trajnime të specializuara, për çdo fushë të caktuar sipas paragrafit 4 të këtij neni, duhet të aprovohen nga organi kompetent.</p> <p>7. Punëtorëve të sigurimit që u lejohe mbajtja dhe përdorimi i armës së zjarrit, sipas këtij ligji, duhet të përfundojnë edhe trajnimin praktik dhe taktik për gjuajtje me armë të zjarrit dhe të kalojnë provimin shtetëror për aftësimin për përdorim të armës.</p> <p>8. Personi që posedon certifikatën dhe dëshmon se me sukses ka përfunduar trajnimin e specializuar në fushën përkatëse nga institucioni trajnues, duhet të kalojë provimin shtetëror të organizuar nga organi kompetent, si dhe t'i plotësojë kriteret e tjera të përcaktuara sipas këtij ligji, para se t'i lëshohet kartela e identifikimit.</p> <p>9. Ministri me akt nënligjor përcakton mënyrën, rregullat dhe procedurat për zbatim të këtij neni.</p>	<p>6. All topics covered by the programme for training courses and periodic specialised training courses for every field referred to in paragraph 4 of this Article shall be approved by the Competent Body.</p> <p>7. Security Workers allowed to carry weapons according to this Law, shall complete the practical and tactical training for firearm shooting and pass the state exam on the use of Weapons.</p> <p>8. The person holding the certificate and proving to have successfully completed the specialised training in the relevant field issued by a training institution shall pass the state exam organised by the Competent Body and meet other criteria set out in this Law in order to obtain the Identification Card.</p> <p>9. The Minister shall, by a bylaw, determine the manner, rules and procedures for the implementation of this Article.</p>	<p>6. Sve teme programa za specijalizovane obuke za svaku oblast određenu prema stavu 4. ovog člana, moraju se odobriti od nadležnog organa.</p> <p>7. Radnici obezbeđenja kojima je dozvoljeno da drže i koriste vatreno oružje, prema ovom zakonu moraju da završe praktičnu i taktičku obuku za gađanje vatrenim oružjem i položiti državni ispit o osposobljavanju za upotrebu oružje.</p> <p>8. Lice koje poseduje sertifikat i dokazuje da je uspešno završilo specijalizovanu obuku u odgovarajuću oblast izdatu od institucije za obuku, mora položiti državni ispit organizovan od nadležnog organa, kao i da ispunjava druge kriterijume utvrđene prema ovom zakonu, pre nego što mu se izda identifikaciona karta.</p> <p>9. Ministar podzakonskim aktom utvrđuje način, pravila i postupke za sprovođenje ovog člana.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 34</b> <b>Trajnimi rifreskues/ricertifikues</b></p> <p>1. Ricertifikimi është i obligueshëm për çdo vit për: operatorët e mbrojtjes së afërt, rojet e TPG-</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 34</b> <b>Refresher/recertifying training</b></p> <p>1. Annual recertification shall be mandatory for: Close Protection Operator, CIT Guard,</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 34</b> <b>Obuka osvežavanja/resertifikacije</b></p> <p>1. Resertifikacija je obavezna za svaku godinu za: operatere bliske zaštite, čuvare TG-a,</p>

<p>së, punëtorët e sigurimit për infrastrukturë kritike dhe punëtorët e sigurimit të cilëve iu lejohen armët nga organi kompetent sipas këtij ligji.</p> <p>2. Trajnimi rifreskues mbahet një herë në vit në poligonet që posedojnë leje sipas ligjit përkatës për armë dhe ka për qëllim rifreskimin dhe marrjen e njohurive praktike për kryerjen e detyrave, përfshirë edhe përdorimin dhe gjuajtjen taktike me armë të zjarrit.</p> <p>3. Kandidatët të cilët kanë përfunduar trajnimin rifreskues nga paragrafi 2 i këtij neni i nënshtrohen provimit ricertifikues një herë në vit për gjuajtje me armë të zjarrit, siç përcaktohet në nenin 33, paragrafin 7 të këtij ligji.</p> <p>4. Shpenzimet e trajnimit rifreskues dhe ricertifikues i bart poseduesi i lejes.</p> <p>5. Ministri me akt nënligjor përcakton rregullat për zbatim të këtij neni.</p>	<p>Security Worker for Critical Infrastructure and Security Worker who is allowed to carry a weapon by the Competent Body, according to this Law.</p> <p>2. Refresher training shall take place on an annual basis, at shooting ranges licensed according to the relevant Law on Weapons, and aims refreshing and acquiring know-how for performing duties, including the use of tactical shooting with firearms.</p> <p>3. Candidates who have completed the refresher training referred to in paragraph 2 of this Article shall enter the recertifying test for firearm shooting on an annual basis, as set out in Article 33, paragraph 7 of this Law.</p> <p>4. Refresher and recertifying training costs shall be borne by the Licensee.</p> <p>5. The Minister shall, by a bylaw, determine the rules for the implementation of this Article.</p>	<p>radnike obezbeđenja za kritičnu infrastrukturu i radnike obezbeđenja kojima se dozvoljavaju oružja od nadležnog organa prema ovom zakonu.</p> <p>2. Obuka osvežavanja održava se jednom godišnje na poligonima koji poseduju dozvolu prema odgovarajućem zakonu o oružju i ima za cilj osvežavanje i sticanje praktičnih znanja za obavljanje svojih dužnosti, uključujući i upotrebu i taktičko gađanje vatrenim oružjem.</p> <p>3. Kandidati koji su završili obuku osvežavanja iz stava 2. ovog člana, podležu ispitu resertifikacije jednom godišnje za gađanje vatrenim oružjem, kao što se utvrđuje u članu 37, stav 7 ovog zakona.</p> <p>4. Troškove obuke osvežavanja i resertifikacije snosi posedioc dozvole.</p> <p>5. Ministar podzakonskim aktom utvrđuje pravila i postupke za sprovođenje ovog člana.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 35</b> <b>Leja për institucion trajnues në fushën private të sigurisë</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 35</b> <b>License for Training Institution in the field of Private Security</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 35</b> <b>Dozvola za instituciju obuke u oblasti privatnog obezbeđenja</b></p>
<p>1. Për tu pajisur me leje për ofrimin e trajnimeve në fushën private të sigurisë, aplikuesi duhet të plotësojë këto kushte:</p>	<p>1. The applicant shall fulfil the following criteria in order to obtain the license for</p>	<p>1. Da bi se opremio dozvolom za pružanje obuka u oblasti privatnog obezbeđenja, aplikant mora da ispunjava ove uslove:</p>

<p>1.1. të jetë i regjistruar si person juridik në regjistrin e bizneseve në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.2. të ketë kaluar verifikimin e së kaluarës për subjektin që aplikon, pronarët dhe përfaqësuesin e autorizuar të tij, sipas nenit 11, të këtij ligji;</p> <p>1.3. të ketë dëshmi për pronësinë ose për marrje me qira të objektit, të vlefshme së paku për kohën e kërkuar për licencë;</p> <p>1.4. të sigurojë hapësira të nevojshme për mbështetje administrative dhe logjistike;</p> <p>1.5. të sigurojë hapësirë prej së paku 40 m2, të pajisura me pajisje të nevojshme për mbajtjen e ligjëratave;</p> <p>1.6. të sigurojë një sallë për trajnime praktike dhe taktike minimum 40 m2;</p> <p>1.7. të sigurojë pajisjet për mbrojtje nga zjarri;</p> <p>1.8. të ketë të vendosura kamerat e vëzhgimit elektronik në hyrje të objektit dhe</p>	<p>providing training in the field of Private Security:</p> <p>1.1. be registered as a legal person in the business register in the republic of kosovo;</p> <p>1.2. have passed the background check required for the applying entity, founders, owners and responsible persons, as set out in article 11 of this law;</p> <p>1.3. possess proof of ownership or renting of the facility, valid at least for the period required for license;</p> <p>1.4. provide space necessary for administrative and logistics support;</p> <p>1.5. provide spaces of at least 40 m2, having the necessary equipment to hold lectures;</p> <p>1.6. provide a room with at least 40 m2, to be used for practical and tactical training;</p> <p>1.7. provide fire protection equipment;</p> <p>1.8. have electronic surveillance cameras installed at the entry of the building and</p>	<p>1.1. da bude registrovan kao pravno lice u registru biznisa u Republici Kosovo;</p> <p>1.2. da ima pređenu verifikaciju prošlosti za subjekat koji aplicira, njegove vlasnike i njegovog ovlašćenog predstavnika prema članu 11, ovog zakona;</p> <p>1.3. da ima dokaz o vlasništvu ili zakupu objekta, važeći najmanje za vreme zahtevano za licencu;</p> <p>1.4. da obezbedi potrebne prostore za administrativnu i logističku podršku;</p> <p>1.5. da obezbedi prostor od najmanje 40 m2, opremljen potrebnim opremama za održavanje predavanja;</p> <p>1.6. da obezbedi salu za praktične i taktičke obuke minimum 40 m2;</p> <p>1.7. da obezbedi opreme za zaštitu od požara;</p> <p>1.8. da ima postavljena kamere elektronskog nadzora na ulazu objekta i u</p>
--	---	---

<p>në hapësirat e mbuluara sipas nënparagrafit 1.5 dhe 1.6 të këtij neni;</p> <p>1.9. pajisja për ruajtjen e incizimeve, duhet ta ruaj minimum 2 muaj incizimin e vëzhgimit të kamerave nga data e regjistrimit.</p> <p>2. Personeli i detyrueshëm nuk duhet të jetë i dënuar për vepër penale dhe përfshin:</p> <p>2.1. një menaxher në pikën e pranimit që është përgjegjës për mbajtjen dhe evidentimin e dokumentacioneve të kandidatëve për trajnim dhe caktimin e orarit të trajnimit për kandidatë;</p> <p>2.2. një ligjërues për çështje ligjore me diplomë të fakultetit juridik;</p> <p>2.3. një instruktor të certifikuar nga institucioni përkatës për dhënien e ndihmës së parë të pajisur me së paku një CPR model dhe një pajisje për të simuluar plagët (seti i gjurmëve) për trajnimin në fushën e ndihmës së parë;</p> <p>2.4. instruktor të certifikuar nga institucioni përkatës për parandalimin e zjarrit;</p>	<p>areas referred to in subparagraphs 1.5 and 1.6 of this article;</p> <p>1.9. hardware or other storage devices shall keep the records for at least 2 months from the recording date.</p> <p>2. Mandatory staff should not be convicted for criminal offence, including:</p> <p>2.1. a manager at the reception point, who shall be responsible for keeping and recording the documentation of training and scheduling the training of candidates;</p> <p>2.2. a lecturer for legal issues, who has a law degree;</p> <p>2.3. an instructor certified by the relevant institution for providing the first aid equipped with at least one cpr model and equipment to stimulate wounds (moulage kit) for training in the field of first aid;</p> <p>2.4. instructor certified by the relevant institution for fire prevention;</p>	<p>pokrivenim prostorima prema podstavu 1.5 i 1.6 ovog člana;</p> <p>1.9. oprema za čuvanje snimaka mora čuvati najmanje 2 meseca snimak nadzora kamera od datuma snimanja.</p> <p>2. Obavezno osoblje ne sme biti osuđeno za krivično delo, uključujući:</p> <p>2.1. jedan menadžer na tačku prijema koji je odgovoran za vođenje i evidentiranje dokumentacije kandidata za obuku i određivanje rasporeda obuke za kandidate</p> <p>2.2. jedan predavač za pravna pitanja sa diplomom Pravnog fakulteta;</p> <p>2.3. instruktor sertifikovan od strane relevantne ustanove za pružanje prve pomoći opremljen najmanje jednim CPR modelom i uređajem za simulaciju rana (set tragova) za obuku iz oblasti prve pomoći;</p> <p>2.4. instruktor sertifikovan od odgovarajuće institucije za sprečavanje požara;</p>
--	---	--

<p>2.5. minimumi nga një (1) instruktor të certifikuar dhe të autorizuar nga organi kompetent për trajnim në çdo fushë të trajnimit të specializuar të parashikuar në këtë ligj;</p> <p>2.6. instruktor për trajnim praktik për përdorimin e prangave, shkopit dhe taktikat mbrojtëse.</p> <p>3. Plan-programi aprovet nga organi kompetent për trajnim themelor profesional dhe të specializuar për çdo fushë të caktuar.</p> <p>4. Posuedesi i lejes, në rast të ndryshimit të adresës ose të personelit të institucionit trajnues, duhet ta njoftojë organin kompetent brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh dhe të plotësojë kushtet e parapara me këtë ligj.</p> <p>5. Posuedesi i lejes si institucion trajnues në fushën private të sigurisë ka të drejtë për hapjen e degëve të tjera në komunat e Republikës së Kosovës, duke i plotësuar kushtet e këtij neni.</p> <p>6. Ministri me akt nënligjor, përcakton rregullat për zbatimin e këtij neni.</p>	<p>2.5. a minimum of one (1) certified and authorised instructor by the competent authority for training in any specialised training field specified in this law;</p> <p>2.6. an instructor for practical training on the use of handcuffs, batons, and defensive tactics.</p> <p>3. Curriculum approved by the Competent Body for vocational basic and specialised training in certain fields.</p> <p>4. In case of change of the location or staff of the training institution, the Licensee shall inform the Competent Body within fifteen (15) days and the conditions set out in this Law shall be fulfilled.</p> <p>5. The Licensee as a training institution in the field of Private Security shall have the right to open additional branches in the municipalities of the Republic of Kosovo by meeting the conditions of this Article.</p> <p>6. The Minister shall, by a bylaw, set the rules for the implementation of this Article.</p>	<p>2.5. minimum po jednog (1) instruktora sertifikovanog i ovlašćenog od nadležnog organa za obuku u svakoj oblasti specijalizovane obuke predviđene u ovom zakonu;</p> <p>2.6. da ima instruktora za praktičnu obuku za upotrebu lisica, pendreka i odbramenih taktika.</p> <p>3. Plani-program se odobrava od nadležnog organa za osnovne stručne i specijalizovane obuke za svaku određenu oblast.</p> <p>4. Posedioc dozvole, u slučaju promene adrese ili osoblja institucije za obuku, mora da obavesti nadležni organ u roku od petnaest (15) dana, i da ispuni uslove predviđene ovim zakonom.</p> <p>5. Posedioc dozvole kao institucija za obuku u privatnoj oblasti obezbeđenja, ima pravo na otvaranje drugih ogranaka u opštinama Republike Kosovo ispunjavajući uslove ovog člana.</p> <p>6. Ministar podzakonskim aktom utvrđuje pravila za sprovođenje ovog člana.</p>
---	--	--

<p align="center"><b>Neni 36</b> <b>Certifikimi i instruktorëve në fushën private të sigurisë</b></p>	<p align="center"><b>Article 36</b> <b>Certification of instructors in the field of Private Security</b></p>	<p align="center"><b>Član 36</b> <b>Sertifikacija instruktora u oblasti privatnog obezbeđenja</b></p>
<p>1. Personi fizik për tu pajisur me certifikatë për instruktor në fushën private të sigurisë, duhet t'i plotësojë këto kushte:</p> <p>1.1. të ketë moshën mbi 21 vjet;</p> <p>1.2. të ketë së paku 3 vite përvojë pune në fushën e sigurisë;</p> <p>1.3. të ketë kaluar provimin teorik dhe praktik për instruktor në fushën përkatëse nga organi kompetent;</p> <p>1.4. të ketë të kaluar verifikimin e së kaluarës penale.</p> <p>2. Ministri me akt nënligjor përcakton mënyrën e aplikimit, procedurat për mbajtje të provimit, certifikimin, plan-programin dhe njohjen e certifikatave, si dhe procedurat për lëshimin e kartelës zyrtare të identifikimit për instruktorë.</p>	<p>1. To obtain the certificate for instructor in the field of Private Security, the natural person shall fulfil the following conditions:</p> <p>1.1. be over 21 years;</p> <p>1.2. have at least 3 years of work experience in the field of security;</p> <p>1.3. have passed the theoretical and practical exam for an instructor in the relevant field by the competent body;</p> <p>1.4. have successfully passed the criminal background check.</p> <p>2. The Minister shall, by a bylaw, determine the manner of application, procedures for holding the exam, certification, curriculum and recognition of certificates, as well as procedures for issuance of the Official Identification Card for instructors.</p>	<p>1. Fizičko lice da bi se opremilo sertifikatom za instruktora u oblasti privatnog obezbeđivanja mora da ispunjava ove uslove:</p> <p>1.1. da ima više od 21 godine;</p> <p>1.2. da ima najmanje 3 godine radnog iskustva u oblasti obezbeđenja;</p> <p>1.3. da ima položen teorijski i praktični ispit za instruktora u odgovarajuću oblast od nadležnog organa;</p> <p>1.4. da ima pređenu verifikaciju krivične prošlosti.</p> <p>2. Ministar podzakonskim aktom utvrđuje način apliciranja, postupci za održavanje ispita, sertifikaciju, plani-program i priznavanje sertifikata, kao i postupke izdavanja službene identifikacione karte za instruktore.</p>



<b>KAPITULLI V INSPEKTIMI</b>	<b>CHAPTER V INSPECTION</b>	<b>POGLAVLJE V INSPEKCIJA</b>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 37 Inspektimet</b></p> <p>1. Organi kompetent, përmes inspektimeve të rregullta, të përsëritura dhe të jashtëzakonshme mbikëqyr zbatimin e këtij ligji nga të gjithë ata që ushtrojnë veprimtarinë private të sigurimit.</p> <p>2. Inspektimet kryhen nga inspektorët për shërbimet private të sigurisë, të caktuar dhe të autorizuar nga organi kompetent.</p> <p>3. Inspektorët kanë të drejtë të inspektojnë Qendrën e certifikuar të Kontrollit, për të siguruar se i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ligj.</p> <p>4. Inspektorët kanë të drejtë të hyjnë në hapësira të punës të poseduesit të lejes dhe aty ku ushtrohet veprimtaria private e sigurimit 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, pa paralajmërim paraprak, vetëm për qëllime të inspektimit.</p> <p>5. Kur gjatë inspektimeve mund të ketë rezistencë që rrezikon inspektorët, organi kompetent mund të kërkojë asistencën e policisë.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 37 Inspections</b></p> <p>1. The Competent Body shall, through regular, repeated and extraordinary inspections, supervise the implementation of this Law by all those exercising Private Security Activities.</p> <p>2. Inspections shall be conducted by Private Security Service Inspectors assigned and authorised by the Competent Body.</p> <p>3. Inspectors shall have the right to inspect the Certified Control Center to ensure that it complies with the conditions specified in this Law.</p> <p>4. Inspectors shall have the right to enter working premises of the Licensee and where the Private Security Activity is exercised 24/7 without prior warning, only for inspection purposes.</p> <p>5. In case of resistance threatening inspectors during the inspections, the Competent Body may require the police assistance.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 37 Inspekcije</b></p> <p>1. Nadležni organ, redovnim, ponovljenim i vanrednim inspeksijskim nadzorom, vrši nadzor nad sprovođenjem ovog zakona od strane svih koji obavljaju delatnost privatnog osiguranja.</p> <p>2. Inspekcije će obavljati inspektore za usluge privatnog obezbeđenja određene i ovlašćene od nadležnog organa.</p> <p>3. Inspektori imaju pravo da pregledaju sertifikovani Kontrolni centar da bi se obezbedili da ispunjava uslove utvrđene ovim zakonom.</p> <p>4. Inspektori imaju pravo da uđu u radnim prostorijama imaoca dozvole i tu gde se vrši delatnost privatnog obezbeđenja 24 sata, 7 dana u nedelji, bez prethodnog upozorenja, samo za svrhe inspekcije.</p> <p>5. Kada tokom inspekcija, može postojati otpor koji ugrožava inspektore, nadležni organ može zatražiti pomoć policije.</p>

<p>6. Kompania private e sigurimit, punëtorët e sigurimit dhe ata të cilët ushtrojnë veprimtarinë private të sigurimit, duhet të bashkëpunojnë dhe të japin informata dhe të dhëna të sakta organit kompetent, për zbatim të këtij ligji.</p> <p>7. Inspektorët nuk mund të komunikojnë në çfarëdo mënyre me kompanitë private të sigurimit jashtë detyrave të tyre zyrtare.</p> <p>8. Policia e Kosovës duhet t'i dërgojë një kopje të raportit të incidentit organit kompetent në rastet kur në incident janë të përfshirë poseduesit e lejeve, subjektet që ushtrojnë veprimtarinë private të sigurimit apo punëtorët e sigurimit.</p> <p>9. Organi kompetent pezullon çdo aktivitetet aty ku ushtrohet veprimtaria private e sigurimit në kundërshtim me këtë ligj, deri në plotësimin e kushteve të përcaktuara në këtë ligj.</p> <p>10. Ministria me akt nënligjor përcakton mënyrën dhe procedurat e inspektimit, në përputhje me ligjin përkatës për inspektime.</p>	<p>6. Private Security Company, Security Workers and those who exercise Private Security Activity shall cooperate and provide the Competent Body with accurate information and data for implementation of this Law.</p> <p>7. Inspectors shall not, in any way, be involved with Private Security Companies outside their official duty.</p> <p>8. Kosovo Police shall submit a copy of the incident report to the Competent Body in cases where the incident involves Licensees, entities exercising Private Security Activity or Security Workers.</p> <p>9. The Competent Body shall suspend every activity of Private Security that is in contradiction with this Law until the conditions mentioned in this Law are fulfilled.</p> <p>10. The Ministry shall, by a bylaw, determine the manner and procedures of the inspection, in accordance with the relevant Law on Inspections.</p>	<p>6. Privatna kompanija obezbeđenja, radnici obezbeđenja i oni koji vrše delatnost privatnog obezbeđenja, moraju sarađivati i davati tačne informacije i podatke nadležnom organu, za sprovođenje ovog zakona.</p> <p>7. Inspektori ne mogu komunicirati na bilo koji način sa privatnim kompanijama obezbeđenja izvan svojih službenih dužnosti.</p> <p>8. Policija Kosova mora da dostavi kopiju izveštaja o incidentu nadležnom organu u slučajevima kada u incidentu su uključeni posedioci dozvola, subjekti koji vrše delatnost privatnog obezbeđenja ili radnici obezbeđenja.</p> <p>9. Nadležni organ suspenduje svaku aktivnost tu gde se vrši delatnost privatnog obezbeđenja u suprotnosti ovom zakonu, do ispunjavanja uslova utvrđenih u ovom zakonu.</p> <p>10. Ministarstvo podzakonskim aktom utvrđuje način i postupke inspekcije, u skladu sa odgovarajućim zakonom o inspekcijском nadzoru.</p>
--	---	---

<b>KAPITULLI VI TË DHËNAT</b>	<b>CHAPTER VI DATA</b>	<b>POGLAVLJE VI PODACI</b>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 38</b> <b>Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga organi kompetent</b></p> <p>1. Organi kompetent mbledh dhe përpunon të dhënat si në vijim:</p> <p>1.1. të dhënat e aplikuesve, atyre që posedojnë leje për ofrimin e shërbimeve private të sigurisë, institucioneve për trajnime themelore profesionale dhe të specializuara;</p> <p>1.2. të dhënat për punëtorët e sigurimit;</p> <p>1.3. të dhënat për qentë e sigurimit;</p> <p>1.4. të dhënat e automjeteve për transportin e parave të gatshme dhe sendeve të tjera me vlerë;</p> <p>1.5. të dhënat për emblemat dhe uniformat e punës;</p> <p>1.6. të dhënat për pajisjet e sigurimit;</p> <p>1.7. të dhënat për kontratën me klientin;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 38</b> <b>Data collection and maintenance by the Competent Body</b></p> <p>1. The Competent Body shall collect and process the following data:</p> <p>1.1. data of the applicants and licensees for the provision of private security services, vocational basic and specialised training institutions;</p> <p>1.2. data on security workers;</p> <p>1.3. data on security dogs;</p> <p>1.4. data on vehicles for cash and valuables in transit;</p> <p>1.5. data on work emblems and uniforms;</p> <p>1.6. data on security equipment;</p> <p>1.7. data on the contract with the client;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 38</b> <b>Prikupljanje i obrada podataka od nadležnog organa</b></p> <p>1. Nadležni organ prikuplja i obrađuje podatke kao u nastavku:</p> <p>1.1. podaci o aplikantima, onima koji poseduju dozvolu za pružanje usluga privatnog obezbeđenja, institucijama za osnovne stručne i specijalizovane obuke;</p> <p>1.2. podaci o radnicima obezbeđenja;</p> <p>1.3. podaci o psima obezbeđenja;</p> <p>1.4. podaci o vozilimaza transport gotovine i drugih dragocenih stvari;</p> <p>1.5. podaci o amblemima i radnim uniformama;</p> <p>1.6. podaci o opremama obezbeđenja;</p> <p>1.7. podaci o ugovoru sa klijentom;</p>

